




REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE - OPŠTINA VUČITRN
02 Nr. / Br. <u>617-1/13</u>
Nr. i fq. / Br. sh. _____
Data: / Datum <u>28.03.2013</u>
VUSHTRRI

## RAPORT

**PËR SITUATEN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE  
INVESTUESE SI DHE I PUNËS SE KRYETARIT TE KOMUNES – EKZEKUTIVIT PËR  
VITIN 2012**

Mars 2013

## Përmbajtja

Hyrje.....	2
Buxheti .....	4
Prøkurimi.....	5
Ekonomi Bujqësi Pylltari.....	15
Shërbime Publike.....	25
Urbanizmi dhe Mbrojtja e Mjedisit.....	30
Gjeodezi Kadastër dhe Pronë.....	32
Arsimi.....	33
Shëndetësi dhe përkujdesje sociale.....	35
Inspekcioni.....	41
Administrata.....	43
Kulturë Rini dhe Sport.....	44
Mbrojtje dhe Shpëtim.....	47
Njisia për të drejtat e njeriut .....	47
Sekretaria.....	49
Zyra për Integritim Evropiane.....	50
Zyra e Komunikimit me Publikun.....	50
Zyra Lokale e Komuniteteve .....	51
Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi.....	53

## Hyrje

Në raportin për situatën ekonomike financiare, realizimin e planeve investuese si dhe punën dhe aktivitete e ekzekutivit të komunës për v. 2012 është paraqitë puna dhe aktivitetet e Kryetarit të komunës përkatësisht Ekzekutivit të komunës, në përmbushjen e detyrave nga fushëveprimtaria dhe kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj, Statutin e Komunës dhe akte tjera nënligjore.

### Objektivat e realizuara:

- Përfundimi i të gjitha projekteve të bartura nga v. 2011 në v. 2012
- Realizimi i të gjitha projekteve të planifikuara në v. 2011 për v. 2012, përkatësisht;
- Asfaltimi i rrugëve të planifikuara,
- Shtruarja me kuba të rrugëve dhe trotuareve në qytet,
- Realizimi i projekteve të kanalizimit fekal,
- Realizimi i projekteve të rrjetit të ujëajellsit,
- Mirëmbajtja e rrugëve dhe gjelbërimeve,
- Realizimi i punëve për ndërtimin e fabrikës së ujit sipas dinamikës (është në proces),
- Ndërtimi i hapsirave shkollore ( në fsh. Bukosh, Zhilivodë, dhe Gjumnazi në qytet),
- Përmirësimi i cilësisë në mësim,
- Ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore në nivel më të lartë,
- Përkujdesja e shtuar ndaj popullatës në gjendje të rëndë sociale,
- Përkujdesja për jetën kulturore
- Shtimi i buxhetit për zhvillim të bujqësisë dhe bizneseve të vogla
- Propozimet për kuvend për miratim të infrastrukturës së re ligjore ( vendimeve rregulloreve ) të cilat do të jenë në shërbim të qytetarëve,
- Përmirësimi i strukturës kualifikuese në administratën komunale dhe E qeverisja lokale

### Objektiva të realizuara pjesërisht :

- Realizimi i të hyrave vetanake
- Mirëmbajtja e ambientit – menaxhimi jo i duhur i mbeturinave
- Menaxhimi jo i duhur i mbrojtjes së pyjeve

Aktivitetet kryesore të Kryetarit të Komunës - Ekzekutivit të Komunës gjatë v. 2012:

- Angazhimet ditore – koordinimi i punëve me drejtor të drejtorive në bazë të dinamikës, detyrave dhe punëve ditore ,
- Mbajtja e takimeve të rregullta javore me drejtor të drejtorive, përcaktimi i detyrave javore dhe raportimi për detyrat që janë kryer në baza javore,
- Takimet e kohëpaskosme me palë për çështjet apo problemet me të cilat ata janë preokupuar,
- Takimet me qytetarë në tubime të ndryshme duke përfshi dy takimet obligative të parapara me ligj (njena në 6 mujin e parë dhe takimi tjetër në 6 mujin e dytë),
- Takimet e ndryshme me zyrtar në nivel qendror institucional dhe jashtë institucional (shoqëria civile, etj.),
- Takimet me përfaqësues të organizatave qeveritare dhe joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare,
- Takimet me përfaqësues të OSBE, KFOR-it etj.
- Mbledhjet e rregullta mujore me Këshillin Komunal për siguri në Bashkësi,
- Takimet me grupet e ndryshme të komuniteteve,
- Propozim-aktet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje të kuvendit të komunës
- Mbikëqyrja në zbatimin e rregulloreve dhe vendimeve të miratuara në Kuvendin e Komunës,
- Mbikëqyrja e realizimit të buxhetit të komunës për vitin fiskal dhe realizimit të të hyrave vetanake,

- Mbikëqyrja e realizimit të projekteve kapitale te komunës, etj.
- Bashkëpunimi me komunitetin për realizim të projekteve të ndryshme,
- Bashkëpunimin me institucionet qendrore për realizim të projekteve me interes për komunën dhe qytetarët,
- Bashkëpunimin me organizatat e ndryshme, përfaqësues të OJQ përkatësisht shoqërisë civile

Në vijim të këtij raporti do të paraqitet relizimi i punëve dhe aktiviteteve brenda vitit 2012, përkatësisht planet investuese në komunë ashtu siç kërkohet me aktet ligjore dhe nënligjore si dhe planet e punës e v.2012

## **1.Buxheti**

Duke qenë se në mbledhjen e fundit të kuvendit është shqyrtuar në mënyrë të hollësishme informata për pasqyrat financiare të komunës për v.2012 e konsiderojmë të panevojshme që të njejtat gjëra të përfshihen në këtë pjesë të raportit. Megjithatë në vijim paraqesim buxhetin e planifikuar dhe të realizuar në vitin 2012.

Planifikimi i buxhetit për vitin 2012:

- Paga dhe mëditje .....7,222,060.00€
- Mallrat dhe shërbime .....1,062,744.00€
- Shpenzime Komunale ..... 274,750.00€
- Subvencione .....109,863.00€
- Investime Kapitale .....3,823,095.00€
- **Totali i planifikimit të buxhetit është 12,492,512.00€**

Realizimi i buxhetit për periudhën Janar-Dhjetor/2012

- Paga dhe mëditje .....7,222,254.75€
- Mallrat dhe shërbime ..... 1,214,565.08€
- Shpenzime Komunale ..... 189,684.80€
- Subvencione .....127,752.80€
- Shpenzime kapitale.....3,291,938.72€

**Totali i shpenzimeve.....12,046,196.15€**

**Shprehur në përqindje realizimi është 96.43 %**

### **Planifikimi i të hyrave vetanake dhe realizimi për periudhën Janar-Dhjetor/2012**

Planifikimi i të hyrave vetanake Janar- Dhjetor /2012 është 1,772,000.00€

Realizimi i të hyrave vetanake Janar- Dhjetor /2012 është 1,192,848.85€

Realizimi i të hyrave vetanake Janar- Dhjetor /2011 është 1,372,107.75€

Shprehur në përqindje realizimi është 67.32%

Krahasuar me periudhën paraprake realizimi i indeksit është 0.87

## 2.Prokurimi

Në periudhën raportuese, Drejtoria, konform dispozitive ligjore që rregullojnë lëmin e prokurimit, ka iniciuar dhe realizuar 192 prokurime për t'i realizuar dhe përmbushur kërkesat për gjitha shtyllat e buxhetit të Autoritetit Kontraktues, si vijon : Administratë Komunale, Arsim, Shëndetësi, Njësia e Zjarrfikësve, Zyra lokale e komuniteteve, dhe Zyra për kthim të komuniteteve.

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat lidhur me Planifikimin dhe realizimin e prokurimeve për vitin 2012.

### KONTRATAT PËR FURNIZIM

Klasifikimi i Produktit (2 shifrat e para nga FPP)	Nr.	Përshkrimi i Kontratës	Njësia	Projekti është realizuar PO / JO
21	1	Furnizimi me material shpenzues për zyre	Kon.	Po
22	2	Furnizim me materiale të shtypura për zyre	Kon.	Po
36	3	Furnizimi me orendi për zyre	Kon.	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
31	4	Furnizimi me pajisje tjera	Kon.	Po
32	5	Furnizimi me paisje për zerim	Kon.	Jo – në mungesë të fondit nga të hyrat
18	6	Furnizimi me veshmbathje	Kon.	Po
15	7	Furnizimi me ushqim dhe pije	Kon.	Po
24	8	Furnizimi me material higjienik	Kon.	Po
11	9	Furnizimi me naftë për ngrohje	Litër	Po
11	10	Furnizimi me naftë për gjenerator	Litër	Po
11	11	Furnizimi me karburante për automjete	Litër	Po
30	12	Furnizimi me teknologji informative dhe pajisje tjera elektronike	Kon.	Po

02	13	Furnizimi me dru për ngrohje	m <sup>3</sup>	Po
10	14	Furnizimi me thëngjill për ngrohje	m <sup>3</sup>	Po
30	15	Furnizimi me aparate fotokopjuese	Kon.	Po
33	16	Furnizimi me medikamente për QKMF-re	Kon.	Po
36	17	Furnizimi me inventar për Trashëgimin Kulturore	Kon.	Jo-nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
34	18	Blerja e automjetit për Pyltari	Kon.	Jo – nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
28	19	Furnizimi me gypa për kanalizim	Kon.	Po
28	20	Furnizimi dhe montimi i sinjalizimit horizontal dhe vertikal të rrugëve dhe udhëkryqeve në qytet	Kon.	Jo – nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
33	21	Furnizime mjekësore	Kon.	Po
31	22	Furnizimi me aparate për matjen e zhurmës	Kon.	Po
29	23	Furnizimi me pajisje trafiku	Kon.	Jo – nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
31	24	Furnizimi me pajisje për ndriqimë	Kon.	po

#### Kontratrat për Shërbime

Klasifikimi i Shërbimit (2 shifrat e para nga FPP)	Përshkrimi i Kontratës	Projekti është realizuar PO / JO
50	1. Servisimi i teknologjisë informative	po
78	2. Botimet e reklamave dhe konkurseve	po
64	3. Shërbimet e internetit	po
55	4. Shërbime hoteliere	po
50	5. Riparimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	po
93	6. Mirëmbajtja higjeno- sanitare e	po

		objekteve komunale	
93	7.	Shërbime tjera kontraktuese të kohëpaskohëshme	po
93	8.	Mirëmbajtja e objekteve	po
77	9.	Gjelbërimi i qytetit	po
60	10	Shërbimet e transportit	po
63	11	Shërbimet e udhimit jashtë vendit	po
85	12	Shërbimet e ndryshme shëndetësore	Jo – nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
93	13	Regjistrimi dhe kontrolla teknike e automjeteve	po
74	14	Hartimi i planeve rregulluese	jo
74	15	Hartimi i projekteve	po
75	16	Sigirimi fizik i objekteve komunale, QKMF-re dhe shkollave	po
93	17	Aero Fotografimi	jo
93	18	Larja dhe pastrimi i automjeteve	po
93	19	Shërbimet intelektuale dhe këshillëdhënëse	Jo – nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
60	20	Shërbimet e udhimit brenda vendit	po
93	21	Mirëmbajtje e mobileve dhe pajisjeve	po

#### KONTRATAT PËR PUNË

Klasifikimi i Punëve (2 shifrat e para nga FPP)		Përshkrimi i kontratës / Karakteristikat thelbësore të secilës kontratë për punë	Projekti është realizuar PO / JO
45	1.	Asfaltimi i rrugës së Krujes	po
45	2.	Asfaltimi i rrugës Azem Galica	po
45	3.	Asfaltimi i rrugës Vllezërit Gërvalla	po
45	4.	Asfaltimi i rrugës Ura e Gurit - Ura	po

		e Sitnicës	
45	5.	Asfaltimi i rrugës nga Pishina e Zariqëve - Ura e Podranqes	po
45	6.	Asfaltimi i rrugës Lidhja e Lezhës deri te permendorja	po
45	7.	Asfaltimi i rrugës Lumni Surdulli - Toplica	po
45	8.	Asfaltimi i rrugës Jeton Tërstena Faza II	po
45	9.	Asfaltimi i rrugës Haxhi Zeka	po
45	10	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Zhilivodë	po
45	11	Asfaltimi i rrugës Kollë-Bruznik	po
45	12	Asfaltimi i rrugës Bukoshë - Oblovik	po
45	13	Asfaltimi i rrugës në fshatin Bruznik	po
45	14	Asfaltimi i rrugës Maxhistrale - Nevolan deri te shkolla	po
45	15	Asfaltimi i rrugës Bukoshë - Liqej - Taraxhë	po
45	16	Asfaltimi i rrugës në fsh. Akrashticë Lagjet Rama dhe Beqiri	po
45	17	Asfaltimi i rrugës Karaq - Gumnisht	po
45	18	Asfaltimi i rrugës Maxhunaj-Maxhistrat-tre gurt e Zekollëve	po
45	19	Asfaltimi i rrugëve në Sfaraqak Xhafa-Menxhiqi	po
45	20	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Mavriq	po
45	21	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Stanove	po
45	22	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumnicë e Epërme	po



45	23	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Prelluzhë	po
45	24	Asfaltimi i rrugëve në Fshatin Bivolak	po
45	25	Asfaltimi i rrugës Dëshmorët e Kombit	Po - project tre vjeçar
45	26	Asfaltimi i rrugës në fshatin Kollë lagja Islami	po
45	27	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Beqiq	po
45	28	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dubovc	po
45	29	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Tërllabuq	po
45	30	Ndërtimi i zyrës së vendit në Pantinë	Jo – nuk është inicuar nga njësis e kërkesës
45	31	Ndërtimi i Trotuareve në Vushtri	po
45	32	Ndriqimi Publik i qytetit	po
45	33	Shtrurja e rrugëve me kubza betoni - Fondi për bashkëfinancim	po
45	34	Ndërtimi i kanalizimit në Maxhunaj lagja Haliti	po
45	35	Rikonstruimi i rrugëve	po
45	36	Ndërtimi i rrugëve të rendit të IV-të	po
45	37	Ndërtimi i kanalizimit në Studime të Poshtme	po
45	38	Ndërtimi i kanalizimit në fshatin Begaj - Ekstra	po
45	39	Ndërtimi i lapidarit dhe rregullimi i varrezave të Dëshmorëve	Jo – nuk është inicuar nga njësis e kërkesës
45	40	Fasadimi i ndërtesave publike	Jo - nuk është inicuar nga njësis e kërkesës
45	41	Riasfaltimi i rrugëve	po
45	42	Renovimi i ndërtesave	Jo - nuk është inicuar nga njësis e kërkesës
45	43	Rregullimi i lumenjëve dhe	Jo - nuk është inicuar nga njësis e kërkesës

		bademave	
45	44	Fondi për bahkfinancim në Blektori	Po – perms drejtorisë për Ekonomi , Bujqësi dhe Zhvillim Ruaral
45	45	Fondi për bahkfinancim në Perim-Kultur	Po- perms drejtorisë për Ekonomi , Bujqësi dhe Zhvillim Ruaral
45	46	Rregullimi i oborrit dhe rrethojës së Qendrës për Punë Sociale	Jo - nuk është inicuar nga njësis e kërkesës
45	47	Instalimi i oksigjenimit në QKMF-n e re	po
45	48	Rregullimi i toaletave dhe gëlqerosja e QMF-ve dhe AMV-ve	Jo - nuk është inicuar nga njësis e kërkesës
45	49	Ndërtimi i fushave rekreative	Jo - nuk është inicuar nga njësis e kërkesës
45	50	Ndërtimi i shkollës fillore në Zhilivodë	po
45	51	Ndërtimi i shkollës fillore në Pestovë	Jo - nuk është inicuar nga njësis e kërkesës

Edhe në vitin 2012 krahasimi i pasqyrave të prokurimeve të evidentuara dhe të realizuara nga Autoriteti kontraktues na dërgon në konstatimin se kemi një zvogëlim të numrit të prokurimeve i cili kryesisht ka ardhur si rezultat grupimit të projekteve të cilat për nga natyra e realizimit kanë qenë të njëjta, por duke zbatuar një procedurë, me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit, duke pasur parasysh gjithnjë transparencën në raport me Operatorët Ekonomik të interesuar, është arritur që procedimi i projekteve të planifikuara të raelaizohen në kohë dhe në mënyrë të suksesshme. Edhe në vitin 2012 kemi pasur trend pozitiv të rritjes së mjeteve të zotuara dhe të kontraktuara, poashtu, të vlerës së projekteve të realizuara dhe po ashtu rritjes së vlerës së mbetur të mejetve financiare si rezultat i zbatimit të procedurave të prokurimit.

Vlenë të theksohet poashtu se përveq projekteve të planifikuara, të cilat u pasqyruar në tabelë si më lartë, ashtu sikurse kemi sqaruar dhe në tabelat e projekteve të planifikuara, me rishikimin buxhetor të 2012 – it, nga mjete e mbetura dhe grantet qeveritare nga ministri të Qeverisë së Republikës së Kosovës, janë planifikuar dhe realizuar edhe një numër i konsiderueshëm i projekteve që nuk ishin të parapara në Planifikimin fillestar, e të cilat janë pasqyruar, në mënyrë të detajuar, në Raportin përfundimtarë të prokurimeve të proceduara nga drejtoria Komunale për prokurim në vitin kalendarik 2012, raport ky i bashkangjitur në këtë raport pune.

Në vazhdim, po japim një pasqyrë tabelare - krahasuese të prokurimeve të evidentuara gjegjësisht të prokuruar, për gjitha vlerat dhe procedurat, në vitin 2010 dhe 2011 dhe 2012

Tab.nr.1

Pasqyra tabelare e prokurimeve – kontratave të evidentuara dhe të realizuara gjatë dy viteve të fundit				
Viti	2010	2011	2012	Vërejtje
Numri i prokurimeve ( gjitha procedurat )	248	192	256	
Vlera e parashikuar	4,717,686.83€	5,504.705.32	8,579,493.79€	
Vlera e kontraktuar	4,029.192.62 €	4,840.959.44	7,312,634.42€	
Diferenca mes mjeteve të planifikuara dhe të kontraktuara	688,494.21 €	663,745.88	1,266,859.37€	

Bazuar në të dhënat si më lartë, edhe gjat viti 2012, poashtu, kemi një trend të mirë të rritjes së mjeteve investive kapitale dhe poashtu një rritje të pjesëmarrjes së mjeteve të mbetura si rezultat i zbatimit të procedurave të prokurimit.

Vlenë të thakësohet, poashtu, se nga gjithë aktivitetet e prokurimit të procesuara në këtë vit, 2012, me theks të veçantë te prokurimet për punë, në asnjë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur punë shtesë.

Duhet theksuar po ashtu se për vonesa të parsyeshme në përfundimin e projekteve sipas planit dinamik të kontraktuar drejtoria ka qenë e detyruar që, konform dispozitave të LPP-së dhe Kushteve të përcaktuara në Kontratën e Punës, të aplikoi penale ndaj disa Operatorëve Ekonomik ( 4 Operatorve Ekonomik ) por këto vonesa nuk kanë qenë të asj natyre sa të rezikojnë realizimin e projekteve, në rendë të parë në aspektin cilësor.

Nga këto vonesa janë realizuar të hyra nga pagesa e penaleve të llogaritura ndaj Operatorëve Ekonomik që kanë qenë kontraktorë të Autoritetit Kontraktues – Komunës së Vushtrrisë, në shumë prej 5,769.35€ ndërsa, në pritje të realizimit të penaleve është edhe shuma prej 1,133.26€.

Tabela e dhënë në vijim, Nr. 2 dhe 3 pasqyron në mënyrë më të detajzuar llojin e procedurës së shfrytëzuar, pjesëmarrjen e llojit të procedurës në numrin e përgjithshëm të prokurimeve si dhe pjesëmarrjen në përqindje të procedurave në aktivitetet e përgjithshme të prokurimeve të realizuar gjatë viti 2011 dhe 2012.

Tab. Nr. 2.

Viti 2011					
Prokurimet e realizuara përmes zbatimit të procedurave të prokurimit ( neni 33-37 të LPP-së ) – LPP nr.04/L-042					
Mjetet financiare	Procedurë e hapur	Proc. e neg. pa publ. e njoft. të kontratës	Procedurë e kuotimit të çmimeve	Procedurë për kontratat në vlerë minimale	Gjithsejt
Të zotuar	5,321.401.26 €	00	134,910.43 €	48,393.63 €	5,504.705.32 €
Të kontraktuar	4,661.873.96 €	00	132,447.06 €	46,638.42 €	4,840.959.44 €
Diferenca	659,527.30 €	00	2,463.37 €	1,755.21 €	663.745.88 €

Tab. Nr. 3.

Viti 2012 Prokurimet e realizuara përmes zbatimit të procedurave të prokurimit ( neni 33-37 të LPP-së ) – LPP nr.04/L-042					
Mjetet financiare	Procedurë e hapur ( € )	Proc. e neg. pa publ. e njoft. të kontratës	Procedurë e kuotimit të çmimeve (€)	Procedurë për kontratat në vlerë minimale (€)	Gjithsejt ( € )
Të zotuar	8.317.234,31	00	180.327,17	81.932,31	8.579.493,79
Të kontraktuar	7.059.759,27	00	175.604,73	77.272,42	7.312.634,42
Diferenca	1.257.477,04	00	4.722,44	4.659,89	1.266.859,37
Pjesmarrëja në %, sipas procedurav e	96.54%		2.40%	1.06%	100%

Nga analiza e të dhënave të paraqitura si në tabelën nr. 3 mundë të nxjerrim konkludimin se, edhe në këtë vit 2012, kursimet më të mëdha janë realizuar me rastin e zbatimit të procedurës së hapur, me vetë faktin se aty janë koncentruar edhe mjetet financiare më të mëdha.

Ndërsa, në raport me shumën e përgjithshme të investimeve gjegësisht vlerës së prokurimeve në vitin 2011 ku kemi pasur një mbetje nga aktiviteti i prokurimeve kursim rreth 12.06% nga vlera e buxhetit të përgjithshëm të orjentuar në investime për punë, mallra dhe shërbime, në vitin 2012 kemi një mbetje – kursim prej rreth 17,32 % nga vlera e buxhetit të përgjithshëm të orjentuar në investime për punë, mallra dhe shërbime.

Konsiderojmë me interes të theksojmë se nga gjitha prokurimet e realizuara në këtë vit, që po i referohet edhe ky Raport pune, nuk kemi të evidentuar asnjë ankesë.

Tabela e dhënë në vijim, Nr. 4 dhe 5 pasqyronë në mënyrë më të detajzuar prokurimet e realizuara gjatë viti 2011 dhe 2012, të shprehura në vlerë financiare si dhe të ndara varësisht nga lloji - lënda e prokurimit.

**Tab. Nr. 4. Pasqyra tabelare sipas lëndës së prokurimeve në vitn 2011**

	Mjete financiare të zotuara	Mjete financiare të kontraktuara	Pjesëmarrja në % në vlerën e përgjithshme
Furnizime	810,510.56 €	727,375.77 €	15.02 %
Shërbime	544,703.00 €	500,000.00 €	10.33 %
Shërbime konsulente	/	/	/
Punë	4,149.491.76 €	3,613.583.21 €	74.65 %
Pronësi e paluajtshme	/	/	/
Gjithësejt	5,504.705.32 €	4,840.959.44 €	100 %

**Tab. Nr. 5. Pasqyra tabelare sipas lëndës së prokurimeve në vitn 2012**

Lloji i prokurimit	Vlera e parashikuar (€)	Vlera e kontraktuar (€)	Pjesëmarrja në % në vlerën e përgjithshme
Furnizime	690.277,75	656.222,75	8.98 %
Shërbime	672.496,31	643.670,76	8.80 %
Shërbime konsulente	/	/	/
Punë	7.216.719,73	6.012.740,91	82.22 %
Pronësi e paluajtshme	/	/	/
Gjithësejt	8.579.493,79	7.312.634,42	100 %

### 3. Ekonomi bujqësi-pyllumtari

Objektivat gjatë v. 2012

- ofrimi i shërbimeve të avancuara për biznese;
- bashkëpunimi më i ngushtë me biznese e sidomos me ato prodhuese, të cilat mund të gjenerojnë vende të reja të punës;
- vizitat me të shpeshta nëpër biznese me qëllim të njohjes me mundësitë e zgjerimit të kapaciteteve të tyre, të dëgjohen hallet dhe mundësitë që ka komuna për zbutjen e vështirësive të tyre;
- përgatitja e një broshure që pasqyron munësitë, potencialet dhe bizneset e suksesshme të komunës sonë;
- ofrimin e shërbimeve profesionale për investitorët e huaj si dhe njoftimi me lehtësirat për të zhvilluar biznes në komunën tonë.
- thjeshtimi i procedurave për regjistrimin e bizneseve, kjo është arritur dhe se aplikimi për hapje të një biznesi të ri bëhet vetëm me letërnjoftim.

Më datën 26.06.2012 nga Programi USAID-BEEP(për mjedisin afarist), Komuna e Vushtrrisë është radhitur në vendin e katërt (4), si një nga performuesit më të mëdhenj 2012.

-Deri më 31.12.2012 në QKB në Vushtri janë kryer këto aktivitete:

<u>Nr.</u>	<u>Përshkrimi i aktivitetit</u>	<u>Nr.i llojit</u>	<u>Vërejtje</u>
1.	Biznese të reja ( të regjistruara)	241	
2.	Shuarje të bizneseve	89	
3.	Ndërrime të logove të certifikatave	74	
4.	Ndryshime në bizneset ekzistuese	91	
	<b>Gjithsej</b>	<b>495</b>	

Në vazhdim do të paraqesim në formë tabelare veprimtaritë ekonomike për bizneset e regjistruara për periudhën 01.01- 31.12.2012:

<u>Kodi</u>	<u>VEPRIMTARITË EKONOMIKE</u>	<u>Bizneset prej 01.01-31.12.2012</u>	<u>%</u>
<u>1</u>	<u>2</u>	<u>3</u>	<u>4</u>
A	Bujqësia, gjuetia dhe pylltaria;	28	11.62

B	Peshkimi;	0	0
C	Industria e Minerave dhe Ekstraktuese;	1	0.41
D	Industria përpunuese;	20	8.30
E	Furnizimi me energji elektrike dhe ujë;	0	0
F	Ndërtimtaria;	22	9.13
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe aparateve tjera të amvisërisë ;	80	33.20
H	Hotelet dhe restorantet;	30	12.45
I	Transporti, depot dhe telekomunikacioni;	24	9.96
J	Aktivitetet financiare;	0	0
K	Pasuritë e patundshme:dhënia me qira dhe aktivitetet e biznesit;	16	6.64
M	Administrimi dhe mbrojtja publike, mbrojtja e obligueshme sociale;	4	1.66
N	Arsimi;	1	0.41
O	Aktivitet tjera shoqërore dhe personale.	15	6.22
<b>Totali</b>		<b>241</b>	<b>100</b>

Gjatë kësaj periudhe vërehet një interesim i shtuar i pronarëve për hapjen e bizneseve prodhuese bujqësore e që besojmë se në të ardhmen do të ketë efekte pozitive në ngritjen e nivelit të shtimit të prodhimeve bujqësore.

Vlen të theksohet se gjatë këtij viti kemi ndihmuar sidomos bizneset fillestare dhe bizneset prodhuese rreth aplikimit në shfrytëzimin e donacioneve të ndryshme, të cilat i kanë dhuruar shoqatat e ndryshme joqeveritare.

Në bashkpunim me USAID/DEMI dhe IPAK (MTI) kemi përgatit një brochure në të cilën pasqyrohen disa nga mundësitë dhe potencialet që gjenden në komunën tonë

Poashtu me miratimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale në fillim të këtij viti janë krijuar kushte më të favorshme për të bërit biznes pasi që iu është hequr taksa komunale bizneseve për vitin e parë të operimit, ndërsa janë liruar për një vit nga obligimet e taksës në firmë edhe 25 kategori biznesesh.



**bujqësia:**

Gjatë gjithë vitit janë pranuar dokumentacione – aplikacione nga ana e fermerëve për grande dhe subvencione që shpërndahen nga MBPZHR, ssi dhe janë ndihmuar në hartim të projekteve bujqësore për aplikim, e që gjithsjtë kanë qenë 847 aplikues.

Kushti i përfitimit të grandit nga ministria ka qenë pjesëmarrja në investim me 50%.

**Përfituesit në fondin për subvencionim të MBPZHR:**

<b><u>Nr.</u></b>	<b><u>Përshkrimi i aktivitetit-aplikimi</u></b>	<b><u>Nr.i aplikantëve</u></b>	<b><u>Vërejtje</u></b>
<b><u>1</u></b>	Fermerë që kishin dele apo dhi	45	
<b><u>2</u></b>	Kultivues për bletë	33	
<b><u>3</u></b>	Fermerë të gjedheve që kanë mbi 5 krerë	248	
<b><u>4</u></b>	Kultivues të grurit mbi 2 ha	468	
Gjithsej fermerë përfitues nga subvencionimi:		<b><u>794 fermerë</u></b>	

**Përfitues në fondin për grante/projekte të MBPZHR :**

-Aplikues: 53 të interesuar me projekt dhe shumë të kërkuar 560,000 € (ndërsa deri më tani të konfirmuara 27 projekte në shumë 297.783€ :

	<b><u>Emri</u></b>	<b><u>Mbiemri</u></b>	<b><u>Fshati</u></b>	<b><u>Lleji i grandit</u></b>	<b><u>Shuma €</u></b>
<b><u>1.</u></b>	Fatime	Muli	Vushtri	Ngritje e sipërfa.0.20ha dredhëza	4.000
<b><u>2.</u></b>	Arben	Tahiri	Vushtri	Ngritje e sipërfa.0.20ha dredhëza	4.000
<b><u>3</u></b>	Milaim	Hyseni	Stanovc	Ngritje e sipërfa.0.20ha dredhëza	4.000
<b><u>4.</u></b>	Nuhi	Hasani	Sfaraqak	Ngritje e sipërfa.0.20ha dredhëza	4.000
<b><u>5.</u></b>	Selim	Kosumi	Pestovë	Makinë për nxjerrjen e qepëve	3.950
<b><u>6.</u></b>	<b><u>Nr.</u></b>	Behrami	Vushtri	Makinë për nxjerrjen e qepëve	3.950
<b><u>7.</u></b>	Besa	Sallahu	Vërrnicë	Serrë me sipërfaqe 0.10ha	20.000
<b><u>8.</u></b>	Shaban	Kosumi	Pestovë	Serrë me sipërfaqe 0.05ha	10.000
<b><u>9.</u></b>	Ahmet	Seferi	Shallc	Ngri.e pemishtes me infrastrukturë	29.880
<b><u>10.</u></b>	Mexhit	Zeka	Vërrnicë	Ngirtjen e serrës 500m2	10.000
<b><u>11.</u></b>	Xhelil	Rama	Shallc	Ngri.e pemishtes me infrastrukturë	28.798

<u>12.</u>	Nexhmedin	Saraq	Bivolak	Ngr.e pemishtes me infrastrukturë	16.560
<u>13.</u>	Izet	Ferizi	Brusnik	Ngr.e pemishtes me infrastrukturë	10.800
<u>14.</u>	Gëzim	Ademi	Karaçë	Shtallë	25.000
<u>15.</u>	Mehmet	Aliu	Stroc	Shtallë	25.000
<u>16.</u>	Sabedin	Haradinaj	Stanoc	Infrastrukturë të shtallës	10.000
<u>17.</u>	Veli	Neziri	Dumnicë	Infrastrukturë të shtallës	10.000
<u>18.</u>	Rasim	Ismajli	Banjskë	Infrastrukturë të shtallës	10.000
<u>19.</u>	Burim	Jashari	Begaj	Ngritje e pemishtes	12.000
<u>20.</u>	Hysen	Fejzullahu	Shalë	Ngritje e pemishtes	6.000
<u>21.</u>	Fatmir	Duraku	Prelluzhë	Ngritje e pemishtes	6000
<u>23.</u>	Rifat	Ademi	Pestovë	Ngritja e pemishtes	4.845
<u>24.</u>	Muharrem	Thaqi	Lumadh	Ngritje e pemishtes	6.000
<u>25.</u>	Vedat	Haradinaj	Stanoc	Ngritje e serrës	10.000
<u>26.</u>	Hyra	Shabani	Svaraçak	Infrastrukturë të pemëve	11.700
<u>27.</u>	Zenë	Haradinaj	Stanoc	Makina bujqësore	19.300

**Shuma e përgjithëshme: 297.783€**

Mund të themi se realizimi i projekteve të fermerëve tanë ka shkuar mirë, pra janë 27 fermerë të Komunës së Vushtrisë që deri tani kanë përfituar grante nga MBPZHR-ja.

Këta përfitues janë në fusha të ndryshme: pemëtari, makineri bujqësore, makineri speciale në primkulturë, infrastrukturë në blegtori (shtalla), etj.

Ka vazhduar bashkëpunimin me HIP-Kosova, ku gjatë kësaj periudhe janë shpërnda 10 krrerë të gjedheve qumështore në fshatrat ku ka qenë e përcaktuar më parë. Donacioni vazhdon edhe në këtë vit.

Me HIP-Kosova dhe në bashkëfinancim me përfituesit e është realizuar edhe një projekt të përbashkët që ka të bëjë me shpërndarjen e 25 makinave mjelëse në shumë prej 8000 €.

Me IADK janë zhvilluar aktivitete të ndryshme dhe atë kryesisht në primkulturë dhe blegtori, ku është mbështetur edhe këtë vit nr.i madh i fermerëve, si:

Nr.	Lloji i projektit	Përfitues	Përshkrimi	Vlera në €	Donatori
1	Ngritja e serrës demonstruese;	1	Me sipërfaqe 200 m <sup>2</sup> ;	18,488.50	IADK
2	Ngritja e serrës për prodhimtari organike të perimeve;	1	Me sipërfaqe 200 m <sup>2</sup> ;	27,063.40	IADK
3	Inkubator për mbirje të farave të perimeve;	2	Me vëllim nga 11 m <sup>3</sup> ;	8,352.00	IADK
4	Mbjellja e kornishonve në fushë të hapur;	14	Nga 0.10 ha;	14,578.90	IADK
5	Mbjellja e brokolit dhe lulelakrës në fushë të hapur;	1	Nga 0.20 ha;	1,309.32	IADK
6	Mbjellja e mullagës në fushë të hapur;	3	Nga 0.20 ha;	4,095.00	IADK
7	Makinë për mulqirim;	1	Përgatit leht(bahqet), vendos folinë dhe gypat ujitës;	4,787.11	IADK
8	Stacion agrometeorologjik;	1	Regjistron parametrat klimatik dhe sinjalizon paraqitjen e sëmundjeve në patate, pemë;	5,697.68	IADK
9	Laktofriza, ekomilk, qeramika, inverter, gjenerator;	2	Kapaciteti 500 litra;	14,409.86	IADK
10	Makina mjelëse;	2	Makina për mjeljen e lopëve;	600.00	IADK
11	Makina të silazhit;	3	Makina njërendëshe për silazh;	9,750.00	IADK
12	Model ferma në Dolak/ përkrahje;	1	Gropa septike, hangari dhe sillosi;	10,736.5	IADK
13	Pako higjienike dhe bidona;	37	Pako higjienike dhe bidona për përmirësimin e higjienës të qumështit në ferma;	10,036.99	IADK
14	Bidona për qumësht;	11	Nga dy bidona për qumësht të kapacitetit 20 litërsh;	550.00	IADK

15	Ujëpirëse automatike për lopë;	4	3 l ujëpirëse me gypa adekuat /përmirësim infrastrukturor;	1,300.00	IADK
16	Pajisje për përgatitje të ushqimeve tradicionale;	1	Mbështetja e Shoqatës "Martirët e Lirisë" në Vushtri me pajisje për ushqime tradicionale;	2,026.50	IADK
18	Inventar për zyrë dhe kompjuter.	1	Inventari i zyrës dhe kompjuteri me printer për Shoqatën e grave "Duart e Arta" Studime.	1,120.00	IADK
<b>Gjithsej shuma:</b>				<b>134,901.00</b>	

**-Nga mbështetja e USAID/YEEP (mundësitë e reja) kanë përfituar këta fermerë:**

<u>Nr.</u>	<u>Përshkrimi i projektit</u>	<u>Shuma në €</u>	<u>Përfitues</u>
<u>1</u>	Kultivim i asparagusit(bimë inovative dhe e kërkuar)	4,500	"Exploren Inteligenc"
<u>2</u>	Fidane kornishoni (tranguj të vegjël)	4,000	MIB Trade-Gracë
<u>3</u>	Fidane kornishoni (tranguj të vegjël)	3,500	Driton Morina, Akrashticë
<u>4</u>	Kultivues i sallatës së gjelbërt	4,000	Vedat Haradinaj, Stanoc
	<b><u>Gjithsej:</u></b>	<b><u>16,000.00 €</u></b>	

**-Nga mëshitetja e CDF-it kanë përfituar këta fermerë/biznese:**

<u>Nr.</u>	<u>Përfituesi/ja</u>	<u>Emri i biznesit</u>	<u>Veprimtaria</u>	<u>Adresa</u>	<u>Nr.i punëtor.</u>	<u>Biznesi</u>	<u>Shuma e projektit</u>
<u>1</u>	Burim Përçuku	N.T.P."Burimi Decor"	Prodhim i mobileve	rr."Mujo Ulqinaku"	3	ekzistues	10,000.00
<u>2</u>	Kosovar Cakaj	D.P.Z "Euro Com"	Servisim i automjeteve	fshati "Stanoc i Epërm"	2	ekzistues	8,206.90
<u>3</u>	Agim Karakashi	D.P.Z.A "Auron"	Prodhimi i produkteve të metalit	rr."Ismail Qemali"	4	ekzistues	8,413.70
<u>4</u>	Nebih Hyseni	N.T.P. "Te Nebihi"	Prodhimin e dyerve dhe dritareve	rr."Shote Galica"	3	ekzistues	7,586.20
<u>5</u>	Avni Isufi	D.SH."Agrobublica"	Prodhim i patates	Fshati Pestovë, shtëpia nr 132	2	I ri	7,136.00
<u>6</u>	Ergin Bunjaku	D.P.Z."Bunjaku"	Prodhimi i pajisjeve metalike	rr."Gjon Buzuku" nr.59	7	ekzistues	8,788.90
<u>7</u>	Agim Shalci	Agrosera "Shalci"	Prodhim në serra	rr."Faruk Beqiri"	2	ekzistues	5,480.00
<u>8</u>	Faik Maxhuni	D.SH. Agrokultura "Behari"	Prodhimi i patates	Fshati Maxhunaj p.n	3	I ri	6,184.00
<u>9</u>	Sami Sylejmani	N.SH."Qiqavica"	Prodhim në serra	Fshati Shalle	4	ekzistues	7,782.40
<u>10</u>	Naim Hyseni	N.N.P "Vëllezërit Hyseni"	Prodhim druri	rr."Lutfi Musiqi" nr.39	7	ekzistues	9,600.00
<u>11</u>	Erdogan Pirçi	DPZ"A.M. Vëllezërit Pirçi"	Mirëmbajtje dhe servisim i automjeteve	rr."Gj.K.Skënderbeu" nr.70	5	ekzistues	10,000.00

Me organizatën "LAPSI" kemi subvencionuar 9 kultivues të vegjël të patates me qëllim të stimulimit të tyre, në shumë të përbashkët të këtij projekti 11.036,87 €;

Në rastin e fundvitit 2012, në emër të kryetarit të komunës u shpërblyen me mirënjohje dhe falënderime të gjithë donatorët dhe kontribuesit në zhvillimin e bujqësisë dhe biznesit në Komunën e Vushtrisë, si:

-USAID/BEEP; USAID/DEMI; CDF-ën; USAID/YEEP; IADK-ën; MBPZHR.

Gjatë këtij viti është përfunduar edhe vaksinimi i qenve shtëpiak dhe njëkohësisht ka përfunduar aksioni pranveror dhe vjeshtor për eliminim të qenve endacak.

### Sektori për pylltari:

Gjatë këtij viti janë bërë përpjekje për përmirësimin e gjendjes në pyje, në fillim të vitit është hartuar plani për menaxhimin e pyjeve (në bashkëpunim me APK).

Në periudhën janar-tetor 2012 në Sektorin e pylltarisë janë zhvilluar këto aktivitete:

<u>Nr.</u>	<u>Përshkrimi</u>	<u>Vendi</u>	<u>Nr.për 2012</u>	<u>Nr.për 2011</u>
<u>1</u>	Kontrolla;	Bukogllavë (Vesekoc), Qiçavicë -II-, -III-, Sllakoc	117	96
<u>2.</u>	Konfiskime të masës drusore pa dokumentacion përkatës;	Gjatë shitjes në treg në formë ilegale dhe gjatë terrenit pyjor	64.70 m <sup>3</sup>	22=34.59 m <sup>3</sup>
<u>3.</u>	Fletëparaqitje për kundërvajtje;	Të drejtuara në Gjykatën komunale	70=30.85m <sup>3</sup> (10,991.01€)	56=96.05m <sup>3</sup> (12,046.75€)
<u>4.</u>	Fletëparaqitje penale të dëmit pyjor;	Të drejtuara në Gjykatën komunale	09=42.10m <sup>3</sup> (6.191.01€)	15=60.33m <sup>3</sup> (8,904.51€)
<u>5.</u>	Furnizim me masë drusore;	Familjeve skanmore, zyrës së vendit në fsh.Maxhunaj	33.10 m <sup>3</sup>	0
<u>6.</u>	Kërkesa të parashtruara;	Për prerje në pyjet private	118 copë	84 copë
<u>7.</u>	Shqyrtim të kërkesave;	Kërkesa të shqyrtuara për prerje ligjore në pyjet private	76 copë=1761.89 m <sup>3</sup>	59copë=1,116.06 m <sup>3</sup>
<u>8.</u>	Fletëpagesa;	Pyje publike/pastrim	13 copë=1.780.80€	0
<u>9.</u>	Fletëpagesa;	Pyje private	58 copë=2,253.50€	0
<u>10.</u>	Zjarre;	Vesekoc, Sllakoc, Dumnicë	147 ha	270 ha

<b>11.</b>	Pyllëzime;	Qiqavicë, Qukë e Skoqnes	39 ha	38.011 ha
<b>12.</b>	Të hyra nga pyjet publike;	Qiqavicë, Qukë e Skoqnes, Sllakoc	1,780.80€	93.50 €
<b>13.</b>	Të hyrat nga pyjet private.	Në varësi nga kërkesat	2,553.50 €	1,698.28 €
	<b>Gjithsej të hyra nga pyjet</b>	<b>Private dhe publike</b>	<b>4,334.30 €</b>	<b>1,791.78 €</b>

Në muajin e fundit janë angazhuar edhe 4 punëtorë të rinj- pylltarë me kontratë mbi vepër, për ngritjen e nivelit të kontrollave në terren, meqë numri i punëtorëve ka qenë i pamjaftueshëm për kryerjen e detyrës në ruajtjen e pyjeve.

#### **Përfundim:**

Objektivat dhe aktivitete e realizuara , në realizim dhe të pa realizuara

1.objektivi i parë është realizuar në tërësi.

**Arsyetim:**

Në bashkëpunim me MTI dhe ARBK-në i kemi bartë të gjitha kompetencat që ndërlidhen me regjistrim të biznesit dhe jemi të parët që e kemi fituar të drejtën e implementimit të programit për ndryshime në certifikatën e biznesit, nr.fiskal dhe për certifikatat e TVSH-s, export-import dhe të tjera;

2/Aktiviteti i dytë është realizuar pjesërisht.

**Arsyetim:**

Në kuadër të përmirësimit të kushteve në Sektorin e pylltarisë kemi punuar në pajisjen me mjete komunikuese,

3/Aktiviteti i tretë nuk është realizuar.

**Arsyetim:**

Ky aktivitet ka qenë i planifikuar të realizohet në bashkëpunim me partnerë/donatorë, mirëpo si projekt ka qenë i paraparë të zhvillohet në nivel të Kosovës, ndërsa si rezultat i dështimit të kompanisë furnizuese me serra-model nga Izraeli, ky projekt në këtë vit është i pamundshëm të realizohet;

4/Aktiviteti i katërt është shtyrë në sitnorin vjeshtor për realizim, por ka aktivitete që ndërlidhen me pyjet të cilat janë në proces.

**Arsyetim:**

Si rezultat i vlerësimit të kushteve jo të favorshme nga MBPZHR, ky aktivitet është shtyrë për në stinorin vjeshtor, mirëpo paralel kemi punuar një projekt të cilin e kemi fituar nga MPMS dhe KE që ka të bëjë me pastrimin dhe rrallimin e pishave në fshatrat Sllakoc-Vesekoc (i cili projekt është në proces dhe ka shumën 29,822.00€);

5/Aktiviteti i pestë është realizuar jo në shumën e paraparë si projekt i ri por është bërë pasimi i donacioneve duke i bartë të vegjëlit e gjedheve në familje të tjera.

**Arsyetim:**

Në vitin 2012 në Sektorin për blegtori ka qenë i paraparë që të zhvillohet projekti i pasimit të dhuratës dhe zhvillimi i një projekti të ri në tri fshatra të reja, mirëpo meqenëse ky projekt ka qenë në varshmëri të plotë nga donatori "HPI-Kosova" dhe në mungesë të kapaciteteve të tij është pamundësuar realizimi i projektit. Si rezultat i dështimit të donatorit, kjo shumë e këtij projekti është proceduar për kuvend që të ndryshohet destinimi i këtyre mjeteve për projektin e hartimit të Strategjisë Zhvillimore Lokale;

6/Aktiviteti i gjashtë është realizuar në pjesërisht.

**Arsyetim:**

Në buxhetin komunal ky projekt është planifikuar nga të hyrat vetanake dhe në mungesë të mjeteve ende nuk është përfunduar, mirëpo paralelisht është në punim e sipër një plan i ri i cili parasheh rregullimin e bademave nga dheu i papërdorshëm, nga kompanitë e ndryshme i cili dhe do të hudhet me plan në pikat më emergjente përgjatë bademave të lumit "Silnica";

Aktiviteti i shtatë, tetë, nëntë dhe dhjetë janë realizuar me sukses.

11/Aktiviteti i njëmbëdhjetë është i planifikuar dhe realizuar me sukses në pjesën e dytë të vitit;

12/Aktiviteti i dymbëdhjetë është i realizuar me sukses;

**Sqarim:**

Ky aktivitet është i planifikuar në dy pjesë (pranverë-vjeshtë) është përgatitur edhe informatë e veçantë për kuvendin komunal dhe është përfunduar me sukses;

13/Aktiviteti i trembëdhjetë është i përfunduar me sukses;

14/Aktiviteti i katërbëdhjetë është planifikuar të realizohet në fund të vitit dhe është përfunduar me sukses;

15/Aktiviteti i pesëmbëdhjetë është realizuar me sukses;

16/Aktiviteti i gjashtëmbëdhjetë është realizuar me sukses;

**Aktivitete për herë të parë**



- 1/ Broshura bujqësore që promovon fermerët dhe kulturat më të zhvilluara;
- 2/ Takimi i organizuar me fermerët më të dalluar dhe shpërndarja e mirënjohjeve për suksese (synimi është që ky aktivitet të jetë organizim tradicional);
- 3/ Takimi tashmë i rregullt (2011-2012) në çdo dhjetor me bizneset me storie suksesi në tryezë të rrumbullakët dhe ndarja e mirënjohjeve;
- 4/ Takimi me synim të jetë tradicional me donatorët në çdo fundvit, të cilët kanë kontribuar në politikat e të bërit biznes dhe zhvillim ekonomik si dhe ngritja e fondeve/investimeve për këto çështje;
- 5/ Hartimi i broshurës që pasqyron potencialet/mundësitë dhe të arriturat për ofertën e komunës për investitor;
- 6/ Hartimi dhe publikimi i Profilin Komunal (në proces);
- 7/ Pjesëmarrja në Panairin e Komunave të Kosovës;

#### **4.Shërbime Publike**

##### **Spektori për komunikacion**

Aktiviteti dhe puna e Sektorit për komunikacion, kapërfshirë organizimin dhe harmonizimin e të gjitha punëve të sektorit, duke bërë përpilimin e informatave dhe raporteve në lëmin e komunikacionit brenda qytetit, rrugët lokale, hartimin e planit për sinjalizimin e rrugëve lokale, gjendjen ekzistuese të shenjave të komunikacionit, nevojat për mirëmbajtje, organizimin e transportit publik urbanë-periferik të udhëtarëve, me qëllim të krijimit të kushteve sa më të favorshme për lëvizje dhe qarkullim të qytetarëve krahas sigurisë në nivel më të lartë, si dhe menaxhimin e autoparkut të komunës. Gjatë kësaj periudhe kohore, janë shqyrtuar dhe proceduar të gjitha lëndët, për të cilat janë nxjerrë Vendimet e nevojshme nga ky sektor, prej tyre shqyrtimi dhe zgjedhja e një numri të kërkesave të qytetarëve që kanë të bëjnë me ndalim të automjeteve në vende të ndryshme për ngarkim – shkarkim të mallrave, për parkimin e automjeteve etj.

Është bërë planifikimi i vijave, përgatitja dhe shpallja e konkursit si dhe dhënia e lejeve të punës së bashku me rendin e udhëtimit, kompanive transportuese për bartjen e rregullt publike të udhëtarëve.

Është bërë incizimi dhe identifikimi i gjendjes së shenjave vertikale ekzistuese në qytet, ku një numër sish është dashur të riparohen

Është përpiluar raporti për gjendjen ekzistuese të rrugëve në qytet dhe fshatra të Komunës, duke përfshirë gjatësinë e rrugëve tashmë të asfaltuara dhe gjatësinë e rrugëve të rendit të katërt që ende janë të pa asfaltuara.

Po ashtu janë punuar formularët me shënimet për gjendjen e tërë rrjetit të rrugëve lokale dhe urbane, duke bërë klasifikimin e atyre të asfaltuara dhe të pa asfaltuara, të cilët formular janë dërguar në Ministrinë e Infrastrukturës.

Është bërë incizimi dhe është përgatitur paramasa dhe parallogaria për riparimin e gropave në rrugët e asfaltuara në qytet dhe fshatra, në kuadër të mirëmbajtjes verore të rrugëve lokale, i cili projekt është në fazën e implementimit. Vlera e këtij projekti është 42 000 Euro.

Nësajë të punës së mirë që është bërë kemi pasëngritje të performances, me ç'rast nga MAPL dhe USAID Komuna e Vushtrisë është shpërblyer me fondin stimulues prej 45 000 \$.

### Autoparku i Komunës

Shërbimi i autoparkut posedon 19 automjete, të cilat kanë shërbyer për kryerjen e punëve të Kuvendit Komunal, për periudhën gjashtë mujore Janar-Dhjetor të vitit 2012. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur numri i kërkesave, kilometrat e kaluara si dhe karburantet e harxhuara për automjetet e Kuvendit Komunal për periudhën njëvjeçare prej 01.01.2012 deri 31.12.2012.

Shpenzimet dhe kilometrat e kaluara për periudhën njëvjeçare Janar-Dhjetor 2012

	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersh	Korrik	Gusht	Shtato	Tetor	Nënt.	Dhjetor	Totali
Km	10918	13266	14913	14716	16400	19040	17391	22166	20150	23405	23016	16807	212188
litra	1233	1735	1655	1429	1781	1960	2030	2401	2111	2313	2354	1786	22788
Mesata	11,29	13,00	11,09	9,71	10,85	10,29	11,6	10,8	10,4	9,88	10,2	10,6	10,7 l/km

### Shërbime komunale

Gjatë kësaj periudhe, përveç punëve të planifikuara dhe punëve sipas detyrës zyrtare u kryen edhe punë të shumta të drejtpërdrejta administrative dhe punë menaxhuese të projekteve në teren. Për çdo ditë u pranuan palë dhe grupe të qytetarëve lidhur me zgjidhjen e problemeve të tyre të natyrës së infrastrukturës dhe të shërbimeve komunale.

Në fushën e mirëmbajtjes së gjelbërimit me sukses janë realizuar projektet e planifikuara, si: Plani për pastrimin, mirëmbajtjen dhe kultivimin e parqeve të qytetit; Plani i ruajtjes dhe mirëmbajtjes së rrethojës, inventarit, gjelbërimit dhe drunjve në parqe; Plani i mirëmbajtjes së stazave dhe rrugicave në parqe; Plani i regjenerimit të luleve dhe barit si dhe kositjen e rregullt të barit; Është punuar edhe në planin e mirëmbajtjes së varrezave, në varreza të dëshmorëve, martirëve dhe atyre të qytetit.

### Furnizimi me ujë.

Furnizimi me ujë të pijshëm mbetet problem i pa zgjidhur për qytetarët e komunës sonë deri në përfundimin e ndërtimit të fabrikës së re për përpunimin e ujit në Sukë të Oshlanit. Gjatë këtij viti ishte një dinamikë e shpejtuar e ndërtimit të kësaj fabrike. Presim që në fundin e këtij viti të finalizohet ky projekt.

**Largimi i ujerave të zeza.**- gjatë periudhës raportuese u realizuan projekte të ndërtimit të kanalizimit, si në qytet ashtu edhe në shumë fshatra të komunës.

**Largimi i ujërave atmosferike.-.** Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhëseve të prockave dhe rrjedhave të ujit në qytet.

**Hedhurinat** - ndërmarrja për menaxhimin e hedhurinave, vepron si Kompani Regjionale "Uniteti" Sh.A. në Mitrovicë, njësi operative në Vushtri. Kjo kompani është e vetmja e licencuar nga Zyra Rregullative për ushtrimin e kësaj veprimtarie në regjionin e Mitrovicës. Njësia operative është relativisht mirë e pajisur me kontejner dhe tekniken për transferim të hedhurinave deri në deponin qendrore në Gërmovë të Mitrovicës. Mirëpo, i mungojnë pajisjet speciale për larjen dhe pastrimin e rrugëve. Mund të thuhet se edhe gjatë kësaj periudhe ndërmarrja me sukses e ka bërë grumbullimin dhe bartjen e mbeturinave. Ndërsa si veprimtari dytësore ka krye punë të kontraktuara si: pastrimin e rrugëve të qytetit, punë të ndryshme komunale, pastrimin e rrugëve nga bora e akulli, etj. Me këtë kompani është lidhur kontrata për larjen e rrugëve, realizimi i të cilës po bëhet me sukses.

**Gjelbërimi** - është përgatit dhe me sukses është realizuar plani i gjelbërimit të disa lokacioneve në qytet. Vlera e tenderit është 29 923 Euro si dhe mirëmbajtja pesë mujore e tyre.

**Ndriçimi publik** – Është nënshkruar kontrata për mirëmbajtjen e ndriçimit publik për dy vite.

**Mirëmbajtja e varrezave** - Edhe mirëmbajtjes së varrezave, gjatë kësaj periudhe iu kushtua kujdes i merituar. U bë pastrimi i hapsirave dhe largimi i barit, u punua në mirëmbajtjen e rrethojës dhe punë tjera në varrezat e dëshmorëve, martirëve dhe ato të qytetit etj.

**Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur në mënyrë të detajuar punët e kryera dhe investimet në Shërbimet Publike.**

Nr.	Kryerja e punëve	Bartësi i punëve	Bashkëpunimi me subjektet	Afati i kryerjes	Vlera	Vërejtje
1	Përgatitja dhe dhënia e Rendeve të udhëtimit, kompanive transportuese për bartjen publike të udhëtarëve.	Drejtoria për Shërbime Publike	Bashkëpunimi me Kompanitë transportuese, Inspeksionin, Policinë e Kosovës	Janar		
2	Reduktimi dhe sistemimi i kombibusëve si dhe vendosja e tyre në vend parkim.	Drejtoria për Shërbime Publike	Bashkëpunimi me pronarët e kombibusëve, Inspeksionin dhe Policinë Kosovës	Janar		Janë nxjerrë 18 Vendime
3	Analizë e rrjedhës së qarkullimit të automjeteve në bazë të senseve (kaheve) të lëvizjes në të gjitha rrugët e qytetit,	Drejtoria për Shërbime Publike	Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe nxënësit e SHMT (drejtimi i komunikacionit)	Mars		
4	Krijimi i hapsirave të gjelbruara në shetitore, rr. „Lidhja e Lezhës dhe hapsira te Palestra e sporteve			USAID - Komuna	49,269	
5	Gjelbërimi (Rregullimi i	Drejtoria për		Mars	29,973	

	hapësirave të gjelbëruara dhe mirëmbajtja tyre me drunj dekorativ). Mirëmbajtja e parqeve dhe gjelbërimit të, shtratit të lumit Tërstena,	Shërbime Publike				
6	Rregullimi i parkut te banesat e bardha	Drejtoria për Shërbime Publike		USAID Komuna	16,515	
7	Mirëmbajtja e varrezave të qytetarëve, martirëve dhe dëshmorëve.	Drejtoria për Shërbime Publike			8,000	
8	Aktivitetet për shënimin e muajit të higjienës	Inspektori i mjedisit Inspektori komunal, Drejtoria për SHP	Drejtoria për Prokurim, për Buxhet dhe Drejtoria për urbanizëm.	Prill		
9	Plani i fshirje – larjes së rrugëve në qytet. 01.04.2012– 31.04.2013.	Drejtoria për Shërbime Publike Drejtoria për Inspeksion	Drejtoria për Prokurim dhe Drejtoria për Buxhet	Prill	4 2000	
10	Ndriçimi publik në rrugët që janë ndërtuar dhe që do te ndërtohen	Drejtoria për Shërbime Publike	Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës	Janar-Dhjetor	25,479	
11	Ndërtimi i trotuareve	Drejtoria për Shërbime Publike	Bashkëpunimi me Drejtorinë Urbanizëm dhe Inspektim	Maj-Gusht	100,000	
12	Mirëmbajtja e rrugëve lokale, të asfaltuara si dhe riasfaltimi i rrugëve	Drejtoria për Shërbime Publike	Bashkëpunimi me Drejtorinë e urbanizmit	Maj-Qershor	50,000	
13	Mirëmbajtja e rrugëve te asfaltuara ne fshatin Prelluzhe				9,500	
14	Furnizimi me gypa të kanalizimit (përkrahja teknike dhe financiare e iniciativave të qytetarëve për ndërtimin e rrjetave primare dhe sekondare të kanalizimit)	Drejtoria për Shërbime Publike ajo për Urbanizëm	Drejtorinë për Urbanizëm, Drejtorinë për zhvillim, Komuniteti, Ujësjetësi regional, Donatorët.	Maj-Tetor	45,515	
15	Ndërtimi i kanalizimit në Maxhunaj -Haliti	Drejtoria për Shërbime Publike		Qershor	18,306	
16	Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza në f.sh.	Drejtoria për Shërbime Publike	Drejtorinë për Urbanizëm, për Ekonomi Prokurim dhe	Qershor	19,775	

	Begaj -Ekstra.		Drejtorinë për Buxhet			
17	Ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza Studime të Poshtme.	Drejtoria për Shërbime Publike	Drejtorinë për Urbanizëm, për Prokurim dhe ajo për Buxhet	Korrik	57,760	
18	Ndërtimi i kanalizimit në rr. „Kruja”	DSHP, D. Urbanizmit		Shtator	6,890	
19	Ndërtimi i kanalizimit ne rr. „Lidhja e Lezhes”	DSHP, D. Urbanizmit		Qershor	7,800	
20	Rikonstruimi i rrugëve	Drejtoria për Shërbime Pub.		Mars-Tetor	50,000	
21	Fondi për bashkëfinancim për shtruarjen e rrugëve me kubza betoni si dhe ndertimi i trotuareve	Drejtoria për Shërbime Publike	Bashkëpunimi me Drejtorinë e Urbanizmit, Gjeodezisë dhe Kadastrat	Gjatë vitit	517,282	
22	Mbikëqyrja e rrugëve dhe mirëmbajtja e sinjaleve rrugore në rrugët lokale të Komunës.	Drejtoria për Shërbime Publike	Bashkëpunimi me Inspeksionin	Gjatë vitit		
23	Mirembajtja i rrugëve të rendit të IV	Drejtoria për Shërbime Publike		Shtator	12,000	
24	Incizimi, analizimi i madhësisë dhe dendësisë së çarkullimit në rrugët e qytetit për verifikim të senseve të lëvizjes.	Drejtoria për Shërbime Publike	Bashkëpunimi me nxënësit e ShMT drejtimi i komunikacionit.	Tetor		
25	Përgatitja për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve	Drejtoria për Shërbime Publike		Nëntor	26,000	
26	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të K. Komunës	Drejtoria për Shërbime Publike	Bashkëpunimi me Drejtorinë e Buxhetit dhe Prokurimit	Gjatë tërë vitit, sipas nevojë	20,000	
27	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i disa rrugëve te qytetit	Drejtoria për Shërbime Publike	Komuna -USAID	Shtator	25,479	
28	Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve të K. Komunës	Drejtoria për Shërbime Publike	Bashkëpunimi me Drejtorinë e Buxhetit dhe Prokurimit	Sipas datave të skadimit	15,000	

## 5. Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

### Shfrytëzimi i hapësirës publike

- Janë lidhë 45 kontrata për shfrytëzim të pronës komunale – tokë ndërtimore në të cilat janë vendosë objekte të përkohshme (kiosqe),
- Po ashtu janë aprovuar edhe 22 kërkesa për dhënie në shfrytëzim sezonal të hapësirës publike para lokaleve dhe hapësirave tjera të përkohshme publike.
- Nga dhënia në shfrytëzim e hapësirës publike duke përfshirë edhe hapësirat tjera sezonale para lokaleve afariste janë realizuar të hyra në shumë prej 7.779,53€
- Në 8 raste ju ka marrë drejta palëve për shfrytëzim të përkohshëm të tokës ndërtimore të cilët kanë shkel kontratën dhe kanë kaluar pronën te personi i tret duke dhënë atë me qira.

Ngarkesa e përgjithshme sipas kontratave të lidhura për periudhën raportuese është 13802,80 €, nga kjo shumë janë paguar 11738,30 €.

Gjithashtu janë paguar edhe 2905,62 € - borxh i mbetur nga viti 2011.

Pagesat për vitin 2012 të paguara nga Banka Kombëtare Tregtare janë: 15660.00 €

Gjatë periudhës raportuese për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës ndërtimore dhe hapësirave publike janë inkasuar :

<b>Totali i inkasimit nga shfrytëzimi i pronës komunale në drejtorinë për Urbanizëm.....40087,95€</b>
---

### Spektori për urbanizëm dhe planifikim

- Punë në komisione të ndryshme.....47 raste
- Paramasa dhe paralogari.....29 raste
- Pranime teknike të objekteve.....25 raste
- Mbikqyrje të objekteve dhe projekte kapitale.....37 raste
- Vlerësim të shtëpive të dëmtuara nga lufta.....4 raste

### Spektori i lejes së ndërtimit

- Leje urbanistike.....71
- Refuzime.....46
- Vërtetime.....16
- Pëlqime për rrugë komunale.....15
- Mbikqyrje.....10

<b>Taksa të inkasuara.....2625 €</b>
--------------------------------------

- punimi i protokoleve për caktimin kushteve Urbanistike ..... 86
- caktimin I vijave ndërtimore me rastin e dhënies së lejeve ndërtimore .....23

Lejet ndertimore.....	66
• vazhdimin e lejes ndertimore.....	2
• çertifikata për leje ndërtimore.....	56
• çertifikata për djegien e shtëpive.....	13

Për lëshuarjen e lejeve ndërtimore gjatë vitit 2012 janë inkasuar **115.159.43 €**.

#### Spektori për Mbrojtje të Mjedisit

Për përmirësim të mjedisit janë realizuar projekte të gjelbrimit të sipërfaqeve publie si:

- Projekti " Shtimi i sipërfaqeve të gjelbra të shetitroja afër Lumit Silnica"..... 14,140.00 €
- Projekti "Shtimi i sip. të gjelbra dhe ndërtimi i miniparkut në Rr „L. Lezhës".....27,535.82 € - Projekti "Shtimi i sip. të gjelbra dhe rekreacion në Kompleksin Sportiv" ..... 10,989.70 €
- Projekti " Shtimi i sip. të gjelbra dhe ndërtimi i miniparkut të Banesat e Bardha" ..... 16,515.40 € - Projekti për gjelbërimin e qytetit me drunje dekorativ dhe lule sezonale ..... 29,973.00 €

Është përcjellë mbrojtja e ambientit me qëllim të parandalimit të ndotjeve të parregullsisve ndihmuar nga Policia e Kosovës si dhe janë shqiptuar gjopa për personat të cilët kanë hedhur mbeturina në vende në të cilat nuk ka qenë e lejuar.

Janë organizuar ligjërrata në bashkëpunim me disa organizata jo qeveritare rreth edukimit mjedisor në disa shkolla në qytet dhe në disa fshatra

Pjesmarrja në trajnime ndërkombëtare ( Zhvillimi i qëndrueshëm dhe ekonomia e gjelbër, Itali etj.)

#### 6. Gjeodezi Kadaster dhe Pronë

Nr. Rend.	LËNDËT E ARRITURA janar- dhjetor 2012	Gjithsej
1.	KËRKESAT E PRANUARA	2047
2	AKTVENDIME PËR BARTJE	739
3.	AKT. PËR KORRIGJIMIN E EMRAVE DHE MBIEMRAVE	55
4.	AKTVENDIME PËR REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	91
5.	AKTVENDIME PËR ÇREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	39
6.	VËRTETIME-CERTIFIKATA	640
7.	COPËTIMI-NDARJA FIZIKE	51
8.	CAKTIMI I KUFIJVE	29

9.	EKSPERTIZA GJYQËSORE	15
10.	KOPJE TË PLANIT	575
11.	LISTA POSEDUESE	3532
12.	KËRKESA ZYRTARE TË NDRYSHME	55
13.	UZURPIMET	34
14.	SHPROËNSIMET	22
15.	IDENTIFIKIMI I PARCELAVE	27
16.	KËRKESA NGA KOMPANITË PRIVATE	18
17.	KËRKESA PËR AKP	4
18.	LËNDËT NË PROCEDURË	12
19.	KËRKESA DHE ANKESA TJERA	234

Në periudhën raportuese këtij drejtorati i kanë arritur **739** kërkesa për regjistrimin e bartjes së pronës. Pas zhvillimit të procedurës administrative dhe studimit të lëndëve, ky shërbim ka marr **733** aktvendime me të cilat janë miratuar kërkesat e palëve, kurse në procedurë administrative për vendosje janë edhe **6** kërkesa.

Në buxhetin e Komunës nga regjistrimi i pronës në RDPP janë inkasuar mjete financiare në shumë prej **26500 euro**.

Janë pranuar nga ana e qytetarëve **55** kërkesa për korrigjimin e gabimeve sa i përket emrit apo mbiemrit në regjistrat e pronave, të cilat gabime kanë pasuar nga e kaluara. Pas zhvillimit të procedurës administrative janë aprovuar kërkesat e tilla të qytetarëve dhe kemi nxjerrë Aktvendime mbi korrigjimin e gabimeve.

Janë pranuar gjithashtu **91** kërkesa për regjistrimin e hipotekave dhe **39** kërkesa për çregjistrimin e hipotekave, të paraqitura nga personat fizik dhe juridik. Këto kërkesa janë kryer të gjitha.

Në buxhetin e komunës nga regjistrimi i hipotekave dhe lirimi i hipotekave janë inkasuar mjete financiare në shumë prej **13220 euro**.

Për realizimin e të drejtave të ndihmave sociale, janë paraqitur **11697** kërkesa për lëshimin e certifikatave mbi gjendjen pronësore, dhe të gjitha janë zgjedhur.

Janë pranuar **15** kërkesa, nga ana e qytetarëve, gjykatave, personave juridik, organeve administrative, dhe AKP-së për dhënien e ekspertizave profesionale prej të cilave i kemi vendosur-zgjidhur që të gjitha në afatet e parapara ligjore.

Janë pranuar **575** kërkesa për dhënien e kopjeve të planit për patundshmëritë, ngastrat kadastrale, objektet, pjesët e objekteve, rrugët private dhe ato publike dhe të gjitha janë kryer (përveç rasteve kur na ka munguar elaborati dhe nuk kemi pasur mundësi ta lëshojmë kopjen e planit).

Në buxhetin e komunës nga lëshimi i kopjeve të planit janë inkasuar mjete në shumë prej **2875 euro**.



Janë lëshuar 3532 Certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme me pagesë nga të cilat në buxhetin e komunës janë inkasuar mjete financiare në shumë prej 10595 euro. Nga matjet gjeodezike në terren (ndarje parcele, caktim i kufijve etj.) janë inkasuar mjete financiare në shumë prej 10386 euro.

Janë pranuar dhe shqyrtuar kërkesa zyrtare të ndryshme të parashtruara nga ana e organeve komunale, gjyqësore, institucioneve qeveritare dhe joqeveritare etj.

Janë zhvilluar procedurat e shpronësimit për pronat nëpër të cilat është bërë zgjerimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Dobërlukë, në rr. "Kruja", rr. "Vëllezërit Gërvalla" dhe rr. "Gjon Buzuku" në Vushtrri;

## 7.Arsimi

### Projektet kapitale

- Ka përfunduar renovimi i shkollës në Samadrexhë donacion i komunës dhe CDF;
- Është ndërtuar shkolla e re në fshatin Zhilivodë. Ky projekt është financuar nga komuna, kurse furnizimi me inventar është bërë nga MASHT-i dhe mësimi po vazhdon normalisht nga shtatori i këtij viti;
- Instalimi i ngrohjes qendrore në shkollën fillore në Studime, projekt i komunës;
- Riparimi i ngrohjes qendrore në SHFMU "Enver Hadri" në Smrekonicë;
- Riparimi i ngrohjes qendrore në institucionin parafillor "Foleja";
- Riparimi i ngrohjes qendrore në SHFMU "Migjeni" Stanoc;
- Riparimi i ngrohjes qendrore SHFMU "Mustaf Shyti" Ashlan;
- Furnizim me gjenerator i tri shkollave;
- Janë rregulluar hapësirat e jashtme të shkollave në Bukosh dhe Smrekonicë nga USAID-i, me vlerë (28.182.04 dhe 19.802.78 euro);
- Janë meremetuar njejt sanitare nga KFOR-i -Turk në shkollën fillore "Naim Frashëri" në Vushtrri;
- Nga studentët turq të Holandës është ngjyrosur shkolla në Studime të Epërme, i cili paraqet vazhdimësinë e projektit të filluar para dy viteve "Zbukurimi i ambientit shkollor";
- Nga Norvegjia është dhuruar një autobus donacion për SHMT "Lutfi Musiqi";
- Është mbuluar depoja e lëndëve djegëse e shkollës SHMU-I- dhe është ndërtuar depoja në SHMU-II-ku puna është kryer nga punëtorët teknik të kësaj shkolle.

### Aktivitetet tjera

- Është ngritur struktura kualifikuese me rastin e pranimit të kuadrove të reja arsimore
- Është bërë licencimi i 100 mësimitdhënësve nga MASHT-i, ku simbolizon 100 vjetorin e pavarësisë, ku ishin të përfshira 4 shkolla nga komuna jonë;
- Në QNP është mbajtur trajnimi i këshillave të shkollave nga BEP për rritjen e rolit të këtyre këshillave në shkolla;
- Janë mbajtur trajnime me mësuesit e klasave të para nga MASHT-i, si dhe ka vazhduar trajnimi i drejtorëve nga BEP në Qendrën për Trajnime Profesionale.
- Është realizuar vëllazërimi i 4 shkollave të komunës me 4 shkolla të qarkut të Lezhës.
- Është nënshkruar memorandumi i binjakëzimit me shkollën "Bajram Curri I" në Durrës me shkollën "Andon Zako Çajupi" të Vushtrisë,
- Është mbajtur punëtorja njëditore nga EU-SWAP me të gjithë drejtorët e DKA-së "Prezantimi i doracakut për monitorimin e mësimitdhënësve";
- Janë plotësuar të dhënat e nxënësve për dy shkolla (SHMU -I- dhe SHMT), për projektin SMS Flexy-S i cili mundëson komunikimin në mes nxënësit, prindit dhe arsimtarit;
- Është mbajtur trajnim njëditor me drejtorë të shkollave të mesme të ulëta me temën "Hulumtimi i së drejtës humanitare", organizuar MASHT-i;
- Janë trajnuar dy ditë 20 profesorë të mësimit joformal nga MASHT-i

- Janë trajnuar nga 10 kujdestarë të klasave të dy shkollave ("Lutfi Musiqi" dhe SHMU -I-) të përfshirë në projektin SMS Flexy;
- Është përruruar Qendra për Ngritje Profesionale në SHMU-II-
- SHMU-I- ka marr vendin e parë për filmin e paraqitur në MASHT në gjuhën angleze;
- Është realizuar projekti nga gratë deputete të kuvendit të komunës për ngritjen e cilësisë në mësim, me nxënës që kanë pengesa në shkrim-lexim;
- Është bërë testimi i klasave të IX-ta nga Drejtoria për Arsim, me qëllim që të vlerësohet niveli i suksesit të 1303 nxënësve;
- Në të gjitha shkollat është në proces rregullimi dhe gjelbërimi i hapësirave shkollore,
- Janë pajisur nxënësit e shkollave në qytet me shenja reflektuese nga KFOR-I (LMT) për të krijuar siguri më të madhe për nxënës në komunikacion

### **Suksesi i gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2011/12**

- Është mbajtur test vlerësues nga DKA-ja për klasën e II, III, dhe IV në shkollat ku mësimi mbahet me klasa të përziera - Beçuk, ku kalueshmëria është 22.04%, Karaçë, 37.18 % dhe Studime të Epërme, 39.18 %. Këto të dhëna tregojnë se kjo formë e mësimi nuk jep rezultate të pritura;
- Suksesi i nxënësve në fund të vitit shkollor 2011/12 në shkollat fillore tregon se nga 6770 nxënës, me sukses pozitiv janë 6730 ose 99.4 %;
- Suksesi i nxënësve në fund të vitit shkollor 2011/12 në shkollat e mesme të ulëta tregon se nga 5530 nxënës, me sukses pozitiv janë 5507 ose 99.58 %;
- Suksesi i nxënësve në fund të vitit shkollor 2011/12 në tri shkollat e mesme të larta tregon se nga 4492 nxënës, me sukses pozitiv janë 4257 ose 94.7 %;
- DKA-ja ka organizuar mbajtjen e testit shtetëror për klasët e IX-ta për 1303 nxënës dhe niveli i kalueshmërisë në përqindje është 42.28%, kurse në testin e arritshmërisë që mbahet nga MASH-i ky rezultat është 47.04 %;
- Në testin e maturës në afatin e qershorit janë testuar 1406 maturantë dhe me sukses pozitiv janë 483 nxënës ose 34.35 %, kurse 923 me rezultat negativ ose 65.65 %;
- Në gjimnazin "Eqrem Çabej" këtij testi iu janë nënshtruar 777 nxënës dhe me sukses pozitiv kanë 389 nxënës ose 50.06 %, kurse me sukses negativ 388 nxënës ose 49.93 %;
- Në SHMT "Lutfi Musiqi" janë testuar 314 nxënës dhe me sukses pozitiv 47 ose 15.00 %, ndërsa me sukses negativ 243 ose 85.00 %;
- Në SHMP "Bahri Haxha" janë testuar 315 nxënës, ku 47 prej tyre janë me sukses pozitiv ose 15% dhe 268 negativ ose 85.00 %.

### **8.Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale**

#### **Objektivat dhe aktivitetet gjatë vitit 2012**

- përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore,
- efikasitetin në ofrimin e shërbimeve shëndetësore,
- mirëqenien sociale,
- strehimin,
- shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve,
- planifikimin, menaxhimin dhe monitorimin e buxhetit,
- participimin si dhe detyrat tjera të realizuara në QKMF(Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare), QMF dhe Ambulanca shëndetësore.

## Sektori i shëndetit parësor dhe publik

Shërbimet shëndetësore të cilat i ka ofruar QKMF,QMF dhe ASH

1. Shërbimit të Mjekësisë Familjare (QMF ,AMF)
2. Shërbimit të Emergjencës
3. Shërbimit të Diagnostikës ( Rentgenit dhe Labororit)
4. Shërbimit të stomatologjisë
5. Shërbimit të Vaksinit
6. Shërbimit të Farmacisë .
7. Shërbimit të Administratës dhe Financave
8. Shërbimit të Higjienës
9. Shërbimit Teknik dhe
10. Shërbimit të Transportit të pac. ( auto-ambulancat)

Aktivitete e realizuara të kujdesit primar shëndetësor:

1. Janë ofruar shërbime të kujdesit primar shëndetësor për tërë banorët e Komunës së Vushtrrisë pa dallime në pajtushmëri me ligjin për shëndetësi dhe rregulloret e aprovuara nga MSH duke u bazuar në principet e Mjekësisë Familjare.
  2. Janë ofruar shërbime preventive si:
    - a. -promovim shëndetësor
    - b. -edukim shëndetësor(si për stafin punues edhe për popullatë)
    - c. -imunizimin dhe vaksinimin me qëllim të reduktimit dhe parandalimit të sëmundjeve infektive.
  3. Është bërë diagnostifikimi fillestar , kujdesi elementar shërues,si dhe ndërhyrje të vogla kirurgjike në shërbimin e emergjencës.
  4. Menagjimi i barnave për KPSH.
  5. Kujdesi emergjent dhe stabilizimi i gjendjes së pacientëve emergjent(shërbim 24 orë në ditë).
  6. Shërbimet themelore Stomatologjike.
  7. Vizitat shtëpiake dhe ofrim të kujdesit paliativ për pacientët në stadin terminal shëndetësor.
  8. Kujdesi shëndetësor për nënën dhe fëmijën sidomos në viset rurale.
  9. Shërbimet e shëndetit reprodutiv (kujdesi antenatal dhe postnatal,shërbimet e planifikimit të familjes , dhënja e këshillave , broshurave dhe kontraktivëve.
  10. Shërbimet e shëndetit mental të bazuara në komunitet(identifikimi me kohë të rasteve me çrregullime mentale).
  11. Ngritja e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore përmes punës së vazhdueshme me kartela unike shëndetësore, si dhe menaxhimi i sëmundjeve duke u bazuar në udhërrëfyes standard terapeutik.
  12. Ngritja e cilësisë të Shërbimit Informativ Shëndetësor.
  13. Promovimi i punës ekipore, ruajtja e portës kanë bërë të mundshëm që të ketë sa më pak referime në kujdesin dytësor dhe tretësor.
  14. Zbulimi dhe lajmërimi i sëmundjeve akute infektive.
  15. Zonimi dhe ndarja e kërkuesve të shërbimeve shëndetësore nëpër QMF, si dhe rregullimi i rrjedhjes së pacientit.
  16. Bashkëpunimi dhe kordinimi i punëve me DSHMS si dhe bashkëpunimi me institucionet tjera .
- Viti 2012 shënon vitin e investimeve në teknologjinë informative,është siguruar pajisja serverike e cila u vendos në objektin e Qendrës së Re,në procedim e sipër pajisje shtesë për SISH-in,të cilat hapin rrugën për krijimin e një data baze të sigurt për rexhistrimin e pacientëve dhe shërbimeve të ofruara.

Sa i përket resurseve humane në këtë vit kishim 17 mjekë Specialistë të Mjekësisë Familjare,14 doktor të mjekësisë, 1 specialist i Biokimisë Klinike si dhe 7 stomatolog. Kuadri i mesëm profesional i përbër prej 122 infermier-ve, , 5 tek.rentgeni ,7 teknik laboratorant,1 teknik farmacisë d.m.th gjithsejtë 135 punëtor medicinal të kuadrit të mesëm,30 administrativ duke arrit numri 204.

## Aktivite dhe të arriturat në mjeksinë familjare

Janë të paraqitura në forëm tabelare

VIZITA MJEKËSORE	participimi		Referime		të liruar		pacientë
MJEKËSIA FAMILJARE	17626	19.1%	13630	14.8%	74485	80.9%	92111
EMERGJENCA	5508	23.5%	3853	16.4%	17970	76.5%	23478
STOMATOLOGJIA	2050	14.3%	696	4.8%	12310	85.7%	14360
<b>Totali i vizitave:</b>	<b>25184</b>	<b>19.4%</b>	<b>18179</b>	<b>14%</b>	<b>104765</b>	<b>80.6%</b>	<b>129949</b>
<b>SHËRBIMET</b>	5020	10.6%	0	0	42316	89.4%	47336
<b>Totali i pacientëve:</b>	<b>30204</b>	<b>17.0%</b>	0	0	<b>147081</b>	<b>83.0%</b>	<b>177285</b>

Në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore ka ndikuar edhe edukimi i vazhdue

shëm profesional i gjithë stafit si atij superior përmes QZHMF apo ligjeratave të organizuara në QKMF ashtu edhe kuadrit të mesëm.

### Shërbimi i vaksinimit

- 1) Fëmijët deri 1 vit janë vaksinuar me sukses: me dozën e parë diteper, polio, hepatit B, janë vaksinuar 1146 fëmijë nga 1146 fëmijë sa ishin të planifikuar pra 100%, me dozën e dytë diteper, poli, hepatit B janë vaksinuar 1146 fëmijë (100%), me dozën e tretë diteper, polio, hepatit B janë vaksinuar 1120 fëmijë (97.7%).
- 2) Fëmijët prej 12-23 muaj janë vaksinuar 1071, janë planifikuar 1127 pra suksesi i vaksinimit kalon 95%
- 3) Nxënësit e klasës së parë 6-7 vjet të planifikuar 1265, të vaksinuar 1265
- 4) Klasët e gjashtë 12-13 vjet të planifikuar 1411, të vaksinuar 1411 nxënësit
- 5) Dhe shkollat e mesme mbi 18 vjet të planifikuar 1194, të vaksinuar 1194
- 6)

Tabela e fletëparaqitjeve të sëmundjeve malinje dhe kronike jo infektive

Janar-dhjetor 2012	Nr. Fletëparaqitjeve
Sëmundje malinje	12
Sëmundje kronike jo infektive	87

Sa i përket sëmundjeve infektive- raportimi ka qenë i rregullt. Në bazë të raportit të IRSHP gjatë muajit Janar –dhjetor 2012 në komunën e Vushtrrisë ishin 2726 raste të raportuara me sëmundje infektive, prej tyre 132 me pneumoni, 2250 me diare akute, 194 varicella, 150 dyshimi në influencë.

### Ngritja profesionale dhe trajnimet

Në kuadër të evaluimit të vazhdueshëm profesional mjekët e KPSH- kanë mbajtur ligjerata të rregullta me tema të zgjedhura sipas prioriteteve.

- 1) Kolegiumet profesionale – mujore kryesisht të rregullta në përjashtim të muajit gusht, ku është bërë debat profesional.
- 2) Në vitin 2012 ka filluar grupi i 12 (dymbëdhjetë) i trajnimit të infermierisë familjare deri më tani janë trajnuar 97 infermier, nga ky numër 2 janë trajnere, 4 kanë kaluar me punë në spitalin e Vushtrisë, 5 kanë shkuar në botën e jashtme. Numri i të trajnuarve në KPSH është 88 infermier familjar, ndërsa numri i atyre të patrajnuar gjithësejtë: 41
- 3) Shërbimi i edukimit shëndetësor ka mbajtur takime në komunitet për problemet e caktuara, është bërë edukimi i të rinjëve nëpër shkolla ku është diskutuar për temat si : tuberkulozi, duhani, droga AIDS-SIDA, alkooli etj.
- 4) Në kuadër të emergjencave, është bërë trajnimi dhe çertifikimi i 6 kandidatëve “Personi i parë në vendngjarje”, kursi ka zgjatë 3 javë dhe është kryer me ndihmen zyrës së OBSH-së në Kosovë, trajnimi është kryer në Mitrovicë.

#### **mirëqenie sociale dhe strehimi**

Janë lëshuar 58 certifikata për familje të dëshmorëve, 310 certifikata për familjet e martirëve, 42 certifikata të ndryshme.

Janë lëshuar 59 aplikacione për shërim jashtë vendit.

shpenzimet nga fondi i subvencioneve dhe transferove nga DSHMS për klubet sportive, ndihma për skamnorë – raste sociale, për mjekim, për pagesë të qirasë, si dhe për shoqata e dalura nga lufta, shoqatën e të burgosurve politik, Handikos, si dhe shoqata tjera të ndryshme, gjithsejtë 79.884.00 €.

Qendra për punë sociale

Në Qendren për Punë Sociale – numri I rasteve

Nr.r.	Kategoritë:	
1	Kujdestari	4
2	Kerkesa per adoptim	1
3	Adoptimi	1
4	Periodë para adoptuese	1
5	Strehimi në SOS-Kinderdorf-Prishtinë	2
6	Strehimi në Shtëpinë e Sigurtë-Mitrovicë	9
7	Shtëpia e perkoshme e sigurt- ISF, Prishtinë	1
8	Konflikte martesore	27
9	Numri i fëmijëve nga konfl.martesor	16
10	Fëmijët me vështërsi në sjelle/Delikuenc	63
11	Të sëmurë psikik	6
12	Fëmijet me aftësi të kufizuara	25
13	Dhune familjare ndaj të miturve	1
14	Dhune familjare ndaj femrave	28
15	Ndaj të moshuarve	1
16	Viktimat e trafikiimit të brendshëm	1
17	Strehimi në shtëpinë e pleqve-Prisht.	1
18	Strehim familjare ne komunitet	
19	Martësat për të mitur	9
20	Kujdestaria për raste të veqanta	1
21	Vërtetim për lirim nga shtetësia	354
22	Streh.familjar /tek të afërmit me pagesë	35
23	Krime seksuale	1
24	Kontaktimi prind - fëmijë	13
25	Vërtetim që nuk i është heq zotsia e veprimit	723
26	Asistim në polici	12

27	Pjemarje në seanca gjygjësore	11
28	Bashkpunim me institucione	
29	Konstatim zyrtar	11
30	Shkresa / informata per institucine	7
31	Raporte socioamnestike	10
32	Vendime për kujdestarin / dhe të tjera	4
33	Seanca / konsultime / këshillime	25
34	Kategori të tjera	9
35	Futja e lendëve në bazën e shërbimeve sociale	120
36	Futja e lendëve në bazën e fëmi. me aftsi. të kufizuar	25
37	Regjistrimi i fëmijëve ne Librin Amë të të lindurve	4

<b>Sektori i asistences sociale</b>		
1	Numri i rasteve si kan aplikuar per her të parë	407
2	Numri i familjeve te verifikuara	2.117
3	Numri i rasteve te derguara ne Komision Mjeksor- Mitrovicë	2.182
4	Numri i ankesave te paraqitura nga palët	76
5	Numri i kërkesave për ndihmë momentale	20

## 9.Inspekcion

Nr. rend .	Inspektorët	Nr.i procesverbaleve	Fletparaqitje	Aktivendime / udhëresa	Mbyllje të lokaleve , Largim I Kombi busaBusave nga komunikacioni	Mall i ndaluar nga shitja ,vlera në euro	Mall i asgjësuar
1.	Inspektorët e Tregut 4	829	5	34	37	31142,25 €	
2.	Inspektori Sanitar 2	267	7	81			31142,25 €
3.	Inspektoët e Ndertimtarisë 2	220	49	115			
4.	Inspektori i komunikacionit 2	207	2	21			
5.	Inspektori i Mjedisit 1	102	1				
6.	Inspektori i Veterinarisë 1	277	3	12			
7	Inspektorja e Higjienës 1	71		61			
7.	<b>Totali</b>	<b>1973</b>	<b>67</b>	<b>324</b>	<b>37</b>	<b>31142,25 €</b>	<b>31142,25 €</b>

Subjektet afariste t ëpajisura me pëlqim nga komisioni përkushtet hixhieno-sanitare e teknike

1. Aplikuuar.....217
2. Tëvendosura.....217
3. Mjete tëinkasu.....3940.00 Euro

### Pëlqime Sanitare

1. Aplikuuar.....63



2. Vendosura.....63
3. Mjete të inkasuara.....2190.00 Euro

Gjoha mandatore të aplikuara nga ana e Inspektoratit

1. TË APLIKUARA.....124 raste
2. TË VENDOSURA.....124 raste
3. Mjete te inkasuara ne €.....10330.00

Mallra të larguar nga shitja dhe asgjasiimi i tyre, nëvlerë.....31142,25 €

Vërejtje :

Të gjitha mallrat të cilat janë asgjësuar në fillim janë larguar nga shitja ndërsa asgjasiimi i tyre është bërë më vonë në praninë e proanrit të firmës si dhe janë përcjellur procedurate asgjasimit

Qertifikat të therjeve të kafsheve

1. Qertifikata të therjeve të kafshëve.....748
2. Qertifikat transportit te kafsheve.....32
3. Qertifikat te origjines te produktit.....35
4. Totali.....815

Kërkesa të ndryshme

1. kërkesa të pranuar.....428
2. Kërkesa të shqyrtuara .....361
3. Kërkesa të refuzuara.....58
4. Në procedurë.....9

Të hyrat nga inspekcioni

	Denime Mandatore	Pelqime Sanitare	Pranime teknike
Janar- Dhjetor	124	63	217
Totali në €	10330,00 €	2190,00 €	3940,00 €
<b>Gjithsejt të hyra për viti 2012</b>	<b>16.460,00 €</b>		

## 10. Administrata

Kërkesat e qytetarëve për dok. personale

Nr.	Përshkrimi	Lëshuara	Me pagesë	Pa pagesë	Certifikata të dëmtuara	
1.	Certifikatë e lindjes	29410	22482	6938	1413	
2.	Certifikatë e martesës	8431	6586	1845	416	
3.	Certifikatë e vdekjes	1769	968	801	75	
4.	C e Statusit martesor	2255	2030	225	60	
5.	Certifikatë e shtetësisë	9930	7868	2062	554	
6.	Certifikatë familjare	3255	2429	826	245	
7.	C e kapacitetit martesor	0	0	0	0	
8.	Certifikatë e vendbanimit	11629	9137	2492	266	
9.	Certifikatë në jetë	164	138	26	3	
10.	Akt I vdekjes	232	218	14	0	
	Gjithsejtë	67085	51856	15229	3032	
11.	Regjistrime në R. Lindjes					847
12.	Regjistrime në R. Martesës					803
13.	Regjistrime në R. Vdekjes					223
14.	Regjistrime në R. Shtetësisë					10030
15.	Regjistrime në R. Lindjes JSH					37
Gjithsejtë regjistrime të bëra						12669

Përveç regjistrimeve në Regjistrat e Gjendjes civile dhe lëshimit të dokumenteve janë kryer edhe këto punë si: përcjellja e raporteve të ndryshme për ndryshimet që ndodhin me rastin e lidhjes së martesave apo shkurorëzimeve, në lidhje me përmirësimin dhe ndërrimin e shënimeve personale në regjistrat e gjendjes civile, plotësimin e statistikave, raporteve periodike për Entin Statistikor, Komunën dhe Ministrinë përkatëse, aplikimin për humbje dhe fitim të shtetësisë, regjistrimin dhe ç'lajmërimin e vendbanimeve, përpilimin e deklaratave si dhe lëshimi i dokumenteve të tjera të ndryshme që kanë të bëjnë me gjendjen civile.

Të gjitha regjistrimet që bëhen në regjistrat e gjendjes civile po ashtu regjistrohen edhe në bazën e të dhënave elektronike të gjendjes civile si dhe aplikohet ofrimi i shërbimeve online për të gjitha dokumentet e gjendjes civile.

### Zyra e personelit:

Janë marrë masa për trajnim të në punësve civil, si :

- Sektori i shërbimit civil,
- Sektori i teknologjisë informative
- Sektori i gjendjes civile
- Prokurimi
- Financa etj

### Punësimi:

Punësimi në administratën komunale është bërë në pajtim me procedurat e ligjit për shërbimin civil. Janë plotësuar vendet e lira të punës kryesisht me rastin e pensionimit të nëpunësve civil.

Gjatë pranimit, iu ka kushtuar kujdes i posaqëm pranimit të kuadrove të reja me pregaditje universitare me ç' rast është arrijtë që të përmirësohet struktura kualifikuese e të punësuarve.

## 11. Kultura

Maifestimet kulturore - Organizime për:

Shpalljen e Sportistit të Vitit, Ditën e Pavarësisë – 17 Shkurti, Epopenë e UÇK-së, Ditën e Bibliotekës, Akademi për 2 Maj, Akademi për 22 Maj Ditën e Ambientit, Akademi për Familjen Gërxhaliu, Ditën e Fëmijëve – 1 Qershori, Ditën e Çlirimit – 17 Qershori, 100 vjetorin e Kuvendit të Kurillovës dhe ngritjes së flamurit kombëtar në Vesekofc, Ditën e patates, Takimet e Poeteshave, 100 vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë.

Trashëgimia Kulturore:

Vazhdimi i punës në konservimin e Kalasë, përfundimi i rindërtimit të Kullës së Azem Bejtë Galicës, Nënshkrimi i Memorandumit për Trashëgiminë Kulturore me CHwB dhe MKRS, Vizita në vendet e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore, etj.

Teatri

ka realizuar dy shfaqje premierë:

- Shfaqjen për fëmijë “ Ariu i vogël “
- Shfaqjen “ Dhëndri nga Parisi “

Me shfaqjen “ Dhëndri nga Parisi”, Teatri mori pjesë në Festivalin Kombëtar në Mitrovicë. Fituan shpërblimin për rolin më të mirë ( M ) dhe vendi e III.

Në Teatër, mbahen vazhdimisht ushtrime të ndryshme teatrore me fëmijë dhe të rritur.

Ansambli i këngëve dhe valleve përveç ushtrimeve të përditshme, ka marrë pjesë në të gjitha manifestimet e organizuara nga DKRS.

AKV prezantoi komunën tonë në këto festivale:

- “ANADRINIA JEHON “ Rahovec – vendi i II,
- “ I KËNDOJMË LIRISË “ Klinë,
- Festivali tradicional në Mitrovicë,
- “ GURRA POPULLORE “ Gjilan,
- Festivali Ndërkombëtar në Bergama – Turqi.

AKV përgatitë shumë të rinj në vallëzim dhe instrumente muzikore.

PREMIERË: Valle burimore “ BARESHA “.

Në Qendrën e Kulturës “ Hasan Prishtina “ u themelua Shoqata e Artistëve të Rinj “ Shemsedin Smakolli”. U hapën disa ekspozita me punime figurative. Stafit teknik u angazhua për rregullimin e binave dhe mbajtjen e zërimit kudo që u kërkua nga DKRS.

Biblioteka e qytetit

Biblioteka u pasurua me një numër të konsiderueshëm të librave:

- 2001 ekzemplarë – Komuna ( vlera 5000 € ),
- 660 ekzemplarë – “ KOHA “,
- 33 ekzemplarë – Grupi i Grave Deputete në KK Vushtrri ( vlera 200 € ).

Ky pasurim i fondit të librit, solli frymëzim dhe motivim më të madh për punë dhe njëkohësisht ndikoi direkt që biblioteka të ketë më shumë lexues.

Biblioteka ka organizuar aktivitete të ndryshme si: ekspozitë me libra e poezi, Ditën e Bibliotekës, etj.

Muzeu - Aktivitetet e Muzeut:

- Vazhdimi i punëve në pasurimin e arkivave të videotekës dhe fototekës së muzeut me fotografi dhe incizime.
- Vazhdimi i punëve hulumtuese në zbulimin e artizanateve të zhvilluara dikur, dhe të atyre që janë edhe sot në Vushtrri me rrethinë.
- Përgatitja dhe hapja e ekspozitës me fotografi për nder të ketër vjetorit të “Pavarësisë të Republikës së Kosovës”. Ekspozita me fotografi me pamje festive gjatë ditëve të 16 dhe 17 shkurtit të vitit 2007.
- Përpilimi i një pasqyre të të 66 vendbanimeve-fshatrave dhe qytetit të Vushtrrisë, përcjellja e kësaj pasqyre në Institutin Albanologjik të Prishtinës me qëllim të përfshirjes së komunës së Vushtrrisë në projektin “Eposi i Kreshnikëve në pesë vende të Ballkanit: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Serbi dhe Mali i Zi”. Projekti në fjalë ka për qëllim hulumtimin e “Eposit të Kreshnikëve” dhe futjen nën mbrojtje të UNESCO.
- Hulumtimi dhe përshkrimi i mjeshtërive të instrumenteve muzikore të zonës së Vushtrrisë, si ishin dikur, ndryshimet që i pësuan në kohë dhe hapsirë dhe arkivimi i tyre në muze.
- Ekspeditë hulumtuese e realizuar në fshatrat Banjë dhe Dubovc me profesor nga Universiteti i Prishtinës. Ekspedita kishte për qëllim fotografimin, inqizimin dhe plotsimin e shënimeve lidhur me kalanë e Gjytetit (Dubovcit), gjithashtu edhe fotografimin e stellës mbivarore me mbishkrime latine (gurë varri).  
Edhe ekspedita e realizuar në fshatin Banjë kishte për qëllim fotografimin dhe plotësimin e shënimeve lidhur me “altarin e Jupiterit” dhe gërmadhave të kishës së vogël, ku edhe është marrë guri në fjalë..
- Më 21,22,23 maj është realizuar një bashkëpunim me drejtorët, mësime të mesme dhe nxënësit e shkollave të mesme të larta për t’ju dhënë këshilla në vlerat dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe duke ju shpërnda formular për identifikimin e vlerave tona folklorike.
- Inventarizim, sistemim, konzervim profesional i ekspozitave dhe pastrimi i tyre.
- Vizita të vazhdueshme të muzeut nga nxënësit, studentët, mësime të mesme, qytetarët, por edhe nga ndërkombëtarët.
- Përpilimi i listës me objektet e Trashëgimisë Kulturore të propozuara për mbrojtje.
- Ekspozita për mërgimtarë.
- Pjesëmarrje në simpoziumin gjithëkombëtarë në Tiranë.
- Vizitë studimore në Angli.
- Ekspozitë për nder të festivalit të poezisë “ Takimet e poeteshave shqiptare” dhe 100 vjetorit të pavarësisë.
- Seminar i organizuar nga CHwB.

Sporti - Klubet dhe shoqatat sportive janë ndihmuar nga fondi i komunës për subvencione

Te dhënat për rezultatet e klubeve në mënyrë të detajuar do të mund të gjenden në raportin e DKRS, në Drejtori apo faqen zyrtare të komunës

Arkivi historik

Janë pranuar më shumë se 500 lëndë ( penale e civile ) nga Gjykata Komunale. Këto lëndë i takojnë viteve 1995- 1998 dhe janë duke u sistemuar dhe klasifikuar sipas rregulloreve dhe Ligjit për Arkivat.

Është në përfundim klasifikimi dhe sistemimi i dokumentacionit të vjetër të bartur në objektin e ri. Në kuadër të ngritjes profesionale, është organizuar seminari një ditor për Ligjin e ri për arkivat.

Rinia

Spektori i Rinisë ka mbajtur takime të rregullta me Organizatat Rinore dhe OJQ-të Rinore si në komunën tonë ashtu edhe ato jashtë komunës. Ka bërë prezantime në nivel qendror në lidhje me nevojat dhe kërkesat e rinisë së Vushtrisë.

Ka organizuar aktivitete të ndryshme me rini në të gjitha festat dhe datat e shënuara.

Disa nga aktivitetet e Sektorit të Rinisë:

- Tryeza: Fuqizimi i Rinisë,
- Marshi i Pavarësisë,
- Vlerësimi i nevojave të rinisë,
- Përkrahja e Asamblesë Rinore të Vushtrisë,
- Informimi dhe ndihma për grantet nga Ministria e Kulturës,
- Ndihmë maturantëve për informim dhe udhëzim të karrierës,
- Ndihmë në realizimin filmave dokumentar,
- Përkrahje të aktivitetit " Ta pastrojmë qytetin ",
- Pjesëmarrje në shënimin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Organizim i koncertit të hapur me të gjitha grupet e interesuara rinore, etj.

## 12.Mbrojtje dhe shpëtim

Në muajt e parë të vitit 2012 për shkak të reshjeve të mëdha të bores, është shpallë gjendje emergjente në komunën tonë. Lidhur me këtë është informuar kuvendi në vitin e kaluar në mbledhje të tij në një pikë të veçantë të rendit të ditës. Kështu që tani nuk e shohim të arsyeshme që të përsërisim këtë pjesë të raportit.

Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim, ka bërë identifikimin e pikave emergjente, caktimin e prioriteteve dhe koordinimin sa më efikas në mes subjekteve për reagim të shpejt, profesional dhe me efikasitet në raste të fatkeqësive natyrore, etj. me qëllim të shpëtohen jetat e njerzve në radh të parë, pasurisë, të mirave materiale dhe stabilizimin e situatave eventuale që mund të paraqiten.

DMSH në bashkëpunim me Qendrën Regjionale për Koordinim Emergjent ka punuar për mbledhjen e shënimeve për hartimin e planit për krijimin e bazës të dhënave për rastet Emergjente dhe fatkeqësive në Komunë.

Kemi bashkëpunuar me të gjitha subjektet relevante në veçanti me subjektet Emergjente në komunë ku në mënyrë të saktë janë mbledhur të dhënat të resurseve njerëzore dhe resurseve materialo-teknike që disponon komuna jonë.

Është bërë vizita në objekte të rrezikuara për banim, në bashkëpunim me Drejtorinë e Urbanizmit.

Gjatë këtij viti nga baza e shërbimit të Zjarrfiksave kemi pas dalje për intervenime si vijon:

- 975 për intervenim në të gjitha rastet
- 669 intervenime të zjarreve,
- 38 objekte ndërtimore (shtëpi banimi, objekte përciellse)
- 297 raste janë intervenime teknike,
- 1 raste aksidente rrugore
- 6 raste lajme të rrejshme.

Nga këto zjarre janë krijuar dëme të mëdha materiale të cilat llogariten rreth: 245.450 €. Ky vlerësim është sipas deklaratave të pronarëve të dëmtuar.

Mirëpo me një angazhim permanent të kësaj drejtorie është arritur që shumë probleme të natyrave të ndryshme emergjente në mënyrë të suksesshme të zgjidhen. Rastet më të rënda janë djegia e shtëpive të banimit, ku është dashur të behet evakuimi i familjes dhe të vendosen në objekte tjera, ku komuna bën pagesë e qirave të këtyre familjeve.

Vlen të theksojmë se gjatë kësaj periudhe është intervenuar në 96 raste për furnizim me ujë të pijshëm, pastrimi i rrugëve dhe shesheve të gjitha këto me urdhër të personave përgjegjës të komunës.

### 13.Njësia komunale për të drejta të njeriut

Puna dhe aktivitetet e NJKDNI;

- Vizita e NJKDNI në 12 shkolla fillore ku u diskutua për sigurinë dhe për fushatën kundër narkotikëve dhe trafikimi i qenieve njerëzore;
- Pjesëmarrja e ZBGJ në tryezën roli i grave në qeverisjen lokale me përfaqësuesin e USAID-it;
- Trajnim me nxënësit e SHMU1 për të drejta të fëmijëve, me rastin e 1 Qershorit;
- Anëtarë i KKMDF bisedë me prindërit e fëmijëve në rrugë për largimin e tyre nga rruga dhe kthimi në shkollë;
- ka pasur disa takime pune me komunitetin serb, ashkali e rom ku përveç marrëdhënieve ndëretnike dhe lëvizjen e lirë u realizua edhe fushata për regjistrimin e fëmijëve të komunitetin rom në libra amëz të Republikës së Kosovës, integrimi i fëmijëve rom në arsimin e komunës.
- Pjesëmarrja në punëtorin të organizuar nga OSBE ku temë ishte integrimi i komuniteteve rom në shoqëri dhe e drejta e arsimit të tyre;
- Pjesëmarrja e NJKDNI në punëtorin organizuar nga Zyra e Kryeministrit lidhur me strategjinë kombëtare për të drejta të personave me aftësi të kufizuar 2012-2015;
- Aktivitetet e NJKDNI për sensibilizimin për ditën ndërkombëtare të fëmijëve në punë të rënda
- Organizimi i 1 Qershorit Ditës Ndërkombëtare të Drejtave të Fëmijëve nga ana e ZDF me program të pasur artistik;
- Rifillimi i punës i Asamblesë së Fëmijëve të komunës ZDF;
- Organizimi i fushatës nga ZBGJ kundër braktisjes së nxënësve në shkolla,
- Organizimi i debatit për avancimi i grave në vendimmarrje;
- Organizimi i tryezës Gratë për gratë në vendimmarrje;
- Pjesëmarrja e NJKDNI në trajnimin dhuna në familje;
- Pjesëmarrja e NJKDNI në konferencë me temë Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar në Kosovë;
- Pjesëmarrja e ZBGJ në Kongresin e V Mbarëkombëtarë të gruas shqiptare;
- Shënimi i 16 Tetorit Ditës Ndërkombëtare për "Mundësitë e Barabarta Profesionale për Personat me Aftësi të Kufizuar";
- Shënimi 10 Dhjetorit dita e Nërkombëtare për të Drejta të Njeriut tryez me OJQ;

Janë marrë statistika gjinore në administratën komunale prej vitit 2003 deri më tani;

Viti	F	M	Nr përgj
2003	32	172	204
2004	44	173	217
2005	46	174	220
2006	47	173	221
2007	41	143	184
2008	41	172	213
2009	/	/	/
2010	45	179	224
2011	57	180	227
2012	50	178	228

#### **14.Sekretaria**

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të Sekretarisë, janë kryer punë për Kuvendin dhe Kryetarin e Komunës, të cilat do të paraqiten në vijim:

Për Kuvendin e komunës dhe komitet e tij janë kryer këto punë:

- Janë dhënë udhëzime për mënyrën e pregaditjes dhe harmonizimit të draft dokumenteve për shqyrtim dhe miratim në kuvend,
- Janë caktuar dhe përpiluar rendet e ditës për mbledhje te KK, KPF, K. Komuniteteve
- Janë përgatitur materialet konform LVL-së Statutit dhe Rregullores për punë të kuvendit megjithëse në shumicën e rasteve ato nuk janë dërguar me kohë, për mbledhjet e Kuvendit të Komunës, dhe Komitetit e KK-së,
- Janë Përgatitur procesverbalet për mbledhjet e kuvendit dhe të komiteteve të përhershme;
- Janë hartuar dhe adresuar pyetjet për kryetarin e komunës, gjegjësisht drejtoritë kompetente, të parashtruara nga anëtarët e kuvendit dhe të komiteteve të përhershme ku janë dhë përgjigjet, kryesisht me shkrim,
- Janë hartuar rekomandimet nga mbledhjet e komiteteve;
- Janë hartuar rregullore; vendimeve dhe akteve tjera të miratuara në KK
- Përpiluar shkresa tjera të ndryshme sipas kërkesave të anëtarëve të kuvendit.

Në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës në procedurë të caktuar janë kryer kryesisht këto punë (janë evidentuar dhe përpiluar shkresa):

- Kërkesa të ndryshme të pranuar për kryetarin e komunës..... 250
- Vendime nga Kryetari i Komunës.....423
- Kërkesa nga Kryetari i Komunës për institucionet qendrore..... 44
- Përgjigje në kërkesë për institucione të ndryshme, organizata të vendit dhe të jashtme, qytetarë, shoqërinë civile etj.....19
- Autorizime .....30
- Urdhëresa.....14
- Marrëveshje të ndryshme .....78
- Procesverbale.....13
- Raporte të ndryshme ..... 28
- Njoftime..... 26
- Informata të ndryshme.....18
- Përgjigje në kërkesë për palët ..... 150

• Letër rekomandime.....	11
• Kërkesa të ndryshme për organe të komunës .....	25
• Letërpërkrhaje .....	5
• Ftesa të ndryshme .....	13
• Shkresa tjera.....	150
-----	
Gjithësejt.....	1297

## **15.Zyra për integrime europiane**

### **Punët dhe aktivitetet**

Detyrat nga “Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave” Për këtë është themeluar “Komisionin Komunal për përgatitje për përmbushjen e detyrave që dalin nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave dhe diskutimin e përmirësimit e draft-Strategjisë për Qeverisje Lokale 2013-2016,

Është hartuar “Planin Komunal të Veprimit për përmbushjen e detyrave që dalin nga Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave”.

Me themelimin e Komision Komunal Ri-integrimit në muajin korrik, i është dhënë shtytje procesit të ri-integrimit të personave të riatdhesuar, pasi që në kompetencë të këtij komisioni komunal është bartur vendimmarrja për t’i ndihmuar personat e riatdhesuar me pako ushqimore dhe higjienike, dru zjarri dhe akomodim dhe si rezultat i kësaj personat e riatdhesuar nuk presim më me muaj për marrjen e këtyre ndihmave.

Është realizuar një bashkëpunim i ngushtë me MAPL dhe MIE sa i përket përmbushjes së detyrave nga Udhërrëfyesi për liberalizim të vizave.

Gjatë këtij viti (maj-dhjetor) kam marrë pjesë në takimet e organizuara nga Kolegjiumi i Zyrtarëve për Integrim Evropian i cili vepron në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Gjithashtu kam marrë pjesë edhe në disa punëtori që janë organizuar për mbështetjen e komunave në procesin i integrimin evropian, duke përfshirë këtu punëtorinë e organizuar në Durrës nga Asociacioni i Komunave të Kosovës e cili është mbajtur në muajin Nëntor.

Zyrtari komunal për integrime europiane ka marrë pjesë në punëtori dhe konferenca të ndryshme në nivel vendi si dhe jashtë vendi për të përfituar përvoja të duhura në fushën e përmushjes së detyrave implementimin e planit të partneritetit evropian për v. 2012, si dhe tema tjera si: hyrje në legjislacionin e BE-së dhe njoftimi në detaje me aktet sekondare të legjislacionit të BE-së si vendimet, rregulloret, direktivat, rekomandimet dhe opinionet”. etj..

## **16.Zyra për komunikim mepublikun**

- Në vitin 2012 Komuna e Vushtrrisë, në mediat e shkruara është paraqitur 615 herë – prodhime të publikuara nga zëdhënësi i komunës apo zyra për komunikim me publikun. Prin – “Kosova Sot”, “Zëri”, “Koha Ditore” e më pas vinë “Epoka e Re”, “Lajmi” dhe “Bota Sot”.
- -Në Agjensionin “Kosovapress” nga Komuna e Vushtrrisë ka pasur 132 publikime, gjersa portali “Telegrafi” 22.



- -Në gazetën lokale mujore "Vushtrria INFO", Komuna e Vushtrrisë ka paraqitur aktivitete e saj, më më tepër se gjysmën e gazetës. Lexueshmëria 1000 kopje.
- -Në Radio "Vicianum"- radion lokale, aktivitetet e komunës janë paraqitur 284 herë, duke përfshirë edhe transmetimin direkt të punës së seancave të Kuvendit Komunal.
- Në mediat elektronike- televizionet komuna, gjegjësisht aktivitetet e saj janë paraqitur në 184 raste, ku prijnë storiet e "Klan Kosovës" e më pas RTK-së, etj; përgjithësisht komuna në storiet televizive në TV nacionale është paraqitur më afër 400 minuta.
- Komuna në Web faqen e saj ka publikuar 202 lajme dhe informacione tjera, gjersa ka planet e punës, të publikuara, 15 procesverbale të mbledhjeve të Kuvendit Komunal, 11 vendimet e Kuvendit Komunal, si dhe 4 rregulloret e aprovuara.
- Numri i përgjithshëm i klikimeve në kanalin e Komunës së Vushtrrisë në You Tube është 95,976.
- Numri i përgjithshëm i klikimeve në kanalin You Tube për vitin 2012 është 61.725.
- -Numri i videove të punuara për vitin 2012, ishin 108 video.
- Në këto kanale pasqyrohet përveç videove të punuara edhe lajmet e publikuara nga Komuna e Vushtrrisë.
- -Janë publikuar edhe 5 revista dhe 3 publikime tjera

### Zyra Lokale e Komuniteteve

Puna dhe aktivitetet e ZLK-së:

- Bashkpunimi i knaqshëm me organet e komunës, sidomos sa i përket realizimit të projekteve të ndryshme të infrastruktures në fshatin Prelluzhë.
- Pjesmarrja e rregullt në mbledhjet e Komitetit për komunitete, Këshillin për siguri në bashkësi, komisione të ndryshme,
- mbledhjet me përfaqësues të komunitetit rom ashkali për të trajtuar qështjet dhe problemet me të cilat ballafaqohen,
- Bashkpunimi me Ministrinë e kthimeve, Pushtetit lokaletj.
- Bashkpunimi me OSBE-në sa i përket integritit të komuniteteve pakicë në jetën institucionale dhe shoqërinë kosovare,
- Bashkpunimi me kompaninë "Uniteti" lidhur me eliminimin e deponive ilegale në fsh. Prelluzhë. Megjithatë për shkak të mospagesës ka pas ngecje në këtë drejtim.
- Është themeluar Këshilli lokal përsiguri në përbërje shumë etnike në të cilin trajtohen qështje dhe probleme të ndryshme e që kanë të bëjnë me përmirsimin e marrdhënieve ndër etnike.

-Në këtë këshill është shqyrtuar strategjia për siguri në bashkësi 2012 - 2016

-Janë bërë vizita në fsh.Banjskë për të shqyrtuar mundësitë e kthimit të 4 familjeve serbe

-Janë vizituar rregullisht familje në fshatrat në të cilat jeton komuniteti pakicë sidomos familjet e varfëra për të shqyrtuar mundësitë për të iu ndihmuar materialisht, ku në disa raste kemi pasur sukses përmes donatorëve të ndryshëm.

- Janë mbajtur takime në Ministrinë e kthimeve për të diskutuar mundësitë për kthim të të zhvendosurve.

-Kemi asistuar në 8 raste për ndihmë në ushqim familjeve të riatdhesuara, si dhe një familjeje në fsh.Prelluzhë.

-Janë siguruar mjetet në Zyrën e kryeministrit për ndërtim të 5 shtëpive (1 në Stanoc - shqiptarë dhe 4 në Prelluzhë – serb) .

#### Përfundim,

Në këtë raport kemi paraqitur në mënyrë të hollësishme gjithë angazhimet aktivitetet dhe punën që është bërë nga kryetari i komunës dhe qeveria komunale. Përmes këtij raporti, ju anëtar të nderuar të kuvendit por edhe qytetarët (pasi që ky raport do të bëhet publik në faqen zyrtare të komunës) keni patur mundësinë që të njiheni më për sëafërmi për të gjitha punët përkatësisht të arritura e komunës brenda vitit 2012. Megjithë problemet dhe vështirësitë që i kemi pasur, kemi arritur që mjetet buxhetore të parapara me planin buxhetor si dhe projektet kapitale të planifikuara për vitin 2012, të i realizojmë pothuajë se në tërësi. Ngecje ka patur sa i përket realizimit të planit të të hyrave vetanake buxhetore, mirëpo duam të besojmë se në këtë vit do të jemi më të suksesshëm në këtë drejtim.

Ky raport konsiderojmë se është gjithëpërfshirës, megjithatë ne i mirëpresim sygjërimet e juaja gjatë diskutimeve në mbledhje të kuvendit.

**Sqarim:** Në shtojcë është i bashkëngjitur raporti i Këshillit Komunal për siguri në bashkësi si dhe projektet kapitale të financuara nga donatorët.

Kryetari i Komunës

Bajram Mulaku

## KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Raporti i punës së Këshillit Komunal për Sigurinë Bashkësi është i bazuar në Udhëzimin Administrativ për Themelimin e KKSBB si dhe Planin e Punës së kuvendit për v.2013.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi siq dihet janë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Qëllimi i themelimit të këtij këshilli në bazë të UA është që t'i identifikojë dukuritë negative të cilat mund të ndikojnë në prishjen e rendit dhe sigurisë publike.

Këshilli komunal për Siguri në Bashkësi poashtu ka rol këshillues në çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të të gjitha komuniteteve.

KKSBB në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiave të tij, bashkëpunon me Policinë e Kosovës dhe institucionet qendrore të cilat merren me sigurinë publike, me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të sigurtë në bashkësi si dhe ndërtimin e besimit për jetë të qetë e të sigurt të të gjitha komuniteteve në meset ku ata jetojnë.

Ky këshill ka për qëllim edhe rritjen e vetdijimit të qytetarëve lidhur me sjelljet e dhunshme në komunitet, si dhe ndërtimin e besimit në mes të policisë dhe qytetarëve nëpërmjet të ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në bashkësi.

Këshilli Komunal për Sigurinë Bashkësi, në v.2012 ka kryer funksionin e vet në pajtim me dispozitat e UA në fuqi përthemelimin e KKSBB.

Gjatë v. 2012 ky këshill ka mbajtur gjithësejt 9 mbledhje të rregullta.

Mbledhjet e KKSBB i kanë përcjellë përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së, të cilët kanë dhënë vlerësimet pozitive në punën dhe rolin e KKSBB në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike dhe integrimin e komuniteteve pakicë në jetën shoqërore brenda komunës.

Takimet në këtë këshill janë mbajtur në gjuhët zyrtare në komunë, duke qenë se përbërja e tij është nga të gjitha komunitet e komunës.

Në këto mbledhje pjesëmarrja e anëtarëve të KKSBB ka qenë e kënaqshme dhe secili nga anëtarët e këshillit ka diskutuar çështjet dhe problemet për të cilat ka përfaqësuar në këtë këshill si dhe ka dhënë kontributin e tij në zgjidhjen e problemeve të caktuara.

Në mbledhje janë shqyrtuar çështje lidhur me sigurinë e përgjithshme në komunë për kohën njëmuje, lidhur me gjendjen e sigurisë e ku kanë raportuar rregullisht: Komandanti i Stacionit Policorë në Vushtrri i cili ka njoftuar lidhur me veprat kriminale dhe masat që janë ndërmarrë nga Policia e Kosovës për rastet në të cilat qytetarë kanë ra ndesh me ligjin.

Përfaqësues të komunitetit serb, turk, rom, dhe ashkali kanë raportuar lidhur me gjendjen e sigurisë brenda komuniteteve të cilat i kanë përfaqësuar, kanë prezentuar problemet dhe kerkesat e tyre para anëtarëve të këshillit me të cilat është njoftuar këshilli, ku janë nxjerrë rekomandime për zgjidhjen e problemeve. Komandanti i Stacionit Policorë përveq raportimit të rregullt për gjendjen e sigurisë gjithashtu ka raportuar për bashkëpunimin e mirë me KFOR-in, Policinë e EULEX-it, përfaqësues të komuniteteve gjatë punës në teren ku janë njoftuar më për së afërmi për raportet ndëretnike në vendbanimet multi-etnike në komunën e Vushtrisë.

Trajnimit e anëtarëve të KKSBB

Nën organizim të organizatës Norvegjeze, është mbajtur puntori 3 ditore në Durrës Shqipëri në të cilën përveq anëtarëve të KKSB kanë marrë pjesë edhe përfaqësues tjerë të komuniteteve pakicë në komunë. Gjatë kësaj punëtorie janë këmbërpërvoja dhe njohuri lidhur me ndërtimin e raporteve të mira midis komuniteteve të ndryshme etnike, duke marrë shembuj të vendeve të përparuara demokratike.

Trajnime të ngjajshme janë mbajtur edhe nën organizim të OSBE ku janë fituar përvoja pozitive për sa i përket rolit të KKSB në ndërtimin e marrëdhënieve të mira në mes të komuniteteve.

Nga Raportii MAPL për punën dhe efikasitetin e institucioneve komunale për v.2012 ka dalë se komuna e Vushtrisë rrëdhitet ndër komunat e para në Kosovë për sa i përket numrit të mbajtjes së mbledhjeve të KKSB.

Nga ajo që u cek më sipër mund të nxirret përfundim se KKSB gjatë v.2012, ka kryer funksionin e tij në pajtim me aktin mbi themelimin e tij, duke krijuar rrethana dhe mundësi për partneritet si me Policinë e Kosovës, përfaqësues të të gjitha komuniteteve dhe partner tjerë, për të kontribuar në përmirësimin dhe avansimin e marrëdhënieve ndëretnike për të gjithë qytetarët pa dallim.

Kryesuesi i KKSB

Bajram Mulaku